



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 45 regjistër (JR)
Datë 13.10.2022

Nr. 16 i vendimit
Datë 12.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 12.02.2026, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen nr. 45/2022 (JR), datë 13.10.2022, që i përket:

ANKUESE: Brunilda Çarçiu, inspektore në Inspektoratin e ish-KLD-së, aktualisht KLGj.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 542, datë 20.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 62, 63, dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në datën 12.02.2026, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet e ankueses, znj. Brunilda Çarçiu, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, që përfundimisht kërkoi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ose ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 542, datë 20.06.2022, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Ankuesja, znj. Brunilda Çarçiu, ka ushtruar detyrën e gjyqtares, ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë dhe më pas të inspektore në Inspektoratin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), aktualisht Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, ajo i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), nga të cilat ka rezultuar se:
 - 2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka konstatuar se: (a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (d) nuk ka kryer deklaram të rremë; (e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. DSIK-ja, në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin e deklasifikuar plotësisht, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës të znj. Brunilda Çarçiu.
 - 2.3. KLGj-ja ka dërguar në Komision raportin vlerësues për znj. Brunilda Çarçiu, bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dokumentet ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.
3. Bazuar në nenin 4, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për znj. Brunilda Çarçiu, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 542, datë 20.06.2022.

II. Vendimi i Komisionit

4. Vendimi i Komisionit për znj. Brunilda Çarçiu është marrë bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilat është konkluduar se:

(i) Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.

(ii) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.

(iii) Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

5. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, Komisioni, me vendimin nr. 542, datë 20.06.2022, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu, inspektore në Inspektoratin e ish-KLD-së, sot KLGJ.*

III. Shkaqet e ankimit lidhur me vendimin e Komisionit

6. Ankuesja ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 542, datë 20.06.2022, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji që të vendosë: – *Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar ndaj znj. Brunilda Çarçiu, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti (procesi i rivlerësimit) për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, sepse ankuesja nuk është subjekt rivlerësi. – Nëse Kolegji vlerëson se ankuesja është subjekt rivlerësi, të vendosë konfirmimin në detyrë të znj. Brunilda Çarçiu, me detyrë inspektore në Inspektoratin e ish-KLD-së, sot KLGJ.*
7. Ankuesja, në ankimin drejtuar Kolegjit, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

Pretendime lidhur me statusin si subjekt rivlerësi

8. Në ankimin drejtuar Kolegjit, ankuesja parashtron se nuk e ka statusin e subjektit të rivlerësimit e se ndaj saj nuk duhet të kryhej procesi i rivlerësimit dhe, për këtë arsye, procesi në Komision duhet të përfundonte pa një vendim përfundimtar. Ankuesja pretendon se, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ajo ka qenë ish-gjyqtare, dhe e vetmja mënyrë për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit ishte paraqitja e kërkesës pranë Komisionit, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, e drejtë apo detyrim që nuk është përmbushur nga ana e saj. Ajo e ka paraqitur deklaratën *vetting* dhe dokumentacionin shoqërues në ILDKPKI, në janar të vitit 2017, si inspektore e KLD-së, pa qenë e qartë se cilat ishin datat kufi që do të ndanin magjistratët që do të verifikoheshin nga institucionet e rivlerësimit dhe magjistratët, që më pas do të verifikoheshin nga organet e reja të drejtësisë. Sipas ankueses, Kolegji e ka të konsoliduar qëndrimin se subjektet duhet të kategorizohen si subjekt rivlerësi në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe jo në momentin që Gjykata Kushtetuese është shprehur mbi ligjin nr. 84/2016. Për rrjedhojë, sipas ankueses, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, ajo nuk kishte statusin e inspektore së ish-KLD-së, pasi është emëruar në këtë detyrë në datën 18.11.2016. Për këto arsye, ankuesja pretendon se nuk mund të konsiderohet subjekt rivlerësi dhe nuk duhet t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, në kushtet kur nuk e ka pasur statusin e inspektore, dhe nuk ka paraqitur kërkesë për t'u rivlerësuar si ish-gjyqtare.

Pretendime lidhur me procesin e rregullt

9. Ankuesja parashtron në ankim se procesi i rivlerësimit ndaj saj nuk është kryer nga një “gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj”, siç kërkohet nga neni 6/1 i KEDNJ-së. Sipas saj, përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit është bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga GjEDNJ-ja në çështjen “Oleksandr Volkov kundër Ukrainës”, që përcaktojnë nëse një organ, që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, është një organ i pavarur dhe i paanshëm. Sipas këtyre kriterëve, kërkohet një përfaqësim thelbësor i gjyqtarëve brenda organit disiplinor, ndërkohë që rezulton se asnjë prej anëtarëve të Komisionit nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e emërimit. Anëtarët e Komisionit janë zgjedhur nga një komitet *ad hoc* parlamentar, me një procedurë që ka shumë defekte dhe pa përfshirjen e trupës gjyqësore. Trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen e saj nuk plotëson kriteret e një gjykate të krijuar me ligj, pasi përzgjedhja e anëtarëve është bërë në kundërshtim me kërkesat e Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
10. Ankuesja pretendon se nga Komisioni është cenuar parimi i sigurisë juridike, për shkak të mosnjohjes dhe moszbatimit nga organet e rivlerësimit, të konceptit kushtetues të “dyfishit të pasurisë së ligjshme”. Neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklarimi i më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë është i vetmi shkak për të cilin merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, atëherë ai automatikisht do të konsiderohet se arrin nivel të besueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 59, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Pretendime për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Për pasurinë “banesë private 2 kate”, në bashkëpronësi, në Tiranë

11. Për këtë pasuri, ankuesja kundërshton konkluzionin e Komisionit për një balancë negative prej (-) 206.928 lekësh për justifikimin e investimit për ndërtimin e banesës dhe pretendon se vlera e kostos së banesës së ndërtuar deri në fund të vitit 2000 është 1.727.494 lekë, sipas kostos së ndërtimit të përcaktuar nga EKB-ja, duke zbritur vlerën e zërave të kostove, që nuk kryhen në ndërtimet informale.
12. Për sa u përket burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, ankuesja kërkon në ankim që të përfshihen në analizën financiare edhe të ardhurat nga aktiviteti privat i vjehrrit, R. Ç., për periudhën 1993 – 1999, të cilat duhet të përlllogariten të paktën në vlerën (-) 606.720 lekë. Gjithashtu, ajo kërkon që të konsiderohet si e ardhur e ligjshme dhe të përfshihet në analizën financiare vlera prej 630.000 lekësh, e përfituar në vitin 1997, nga aktiviteti i bashkëshortit si ekspert kontabël i autorizuar.
13. Ankuesja kundërshton llogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën deri në vitin 1999 nga Komisioni, pasi sipas saj, këto shpenzime kanë qenë më të ulëta, për shkak se një pjesë e shpenzimeve familjare mbulohej nga produktet e përfituara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në pronësi të vjehrrit të saj. Për këtë arsye, ajo pretendon se shpenzimet jetike të periudhës duhet të reduktohen edhe me 40% të vlerës që është llogaritur si 30% e të ardhurave dhe jo vetëm me 30%, për shkak të pagave të larta, siç ka konsideruar Komisioni.

14. Në përfundim, për pasurinë “banesë private 2 kate”, në bashkëpronësi, të ndodhur në Tiranë, ankuesja pretendon se ka pasur burime të ligjshme financiare për të përballuar koston e ndërtimit në vitet 1996 – 2000, pasi deri në fund të vitit 2000, rezulton me mundësi kursimi në vlerën 2.466.340 lekë.

*Për pasuritë “apartament me sipërfaqe 56 m²”, Lagjja {***}, Plazh, Durrës, dhe “dyqan”, me sipërfaqe 52.32 m², rruga “{***}”, Tiranë*

15. Ankuesja parashtron se gjendja e likuiditeteve *cash* të akumuluar deri në fund të vitit 2006, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e dy pasurive në vitin 2007, ka qenë në vlerën 6.150.000 lekë, dhe se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* në fund të 2003, në vlerën 5.700.000 lekë, si dhe shtesën gjatë vitit 2006, në vlerën prej 450.000 lekësh. Gjendja *cash* e krijuar deri në fund të vitit 2006 është e mjaftueshme për t’u përdorur si burim për blerjen e dy pasurive objekt verifikimi. Mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurive dhe i pakësimit të gjendjes *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, në kundërshtim nga sa ka konkluduar Komisioni, janë pasaktësi të karakterit formal, të pashoqëruara me pamjaftueshmëri financiare dhe, si të tilla, nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore.

Për të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë me sipërfaqe 52.32 m²

16. Komisioni, edhe pse i ka njohur të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë 52.32 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, për vitet 2009, 2010, 2012, 2016, nuk i ka përfshirë në analizën financiare, pavarësisht provave të paraqitura, si dhe nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e realizuara nga kjo qiradhënie për vitin 2013.

Për gjendjen cash të krijuar deri në datën 03.03.2011

17. Ankuesja parashtron në ankim se gjendja *cash* në fund të vitit 2010 mbetet në shumën 1.500.000 lekë dhe saktësimi për këtë gjendje është bërë në deklaratën e pasurisë të vitit 2016, në sqarimet në ILDKPKI, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision.

Për automjetin tip “Renault”, blerë më datë 06.11.2010

18. Ankuesja kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamundësinë financiare në vlerën (-) 334.170 lekësh, për blerjen e automjetit nga bashkëshorti, duke pretenduar se analiza financiare për të konstatuar mundësinë e blerjes më datë 06.11.2010 rezulton pozitive.

Për automjetin tip “Mercedes-Benz”, blerë më datë 29.05.2010

19. Për blerjen e këtij automjeti, Komisioni ka evidentuar një balancë negative prej (-) 53.357 lekësh, të cilën e ka vlerësuar të pakonsiderueshme, ndërkohë që ankuesja pretendon në ankim se edhe kjo balancë negative, në fakt, nga analiza financiare rezulton të jetë pozitive.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

20. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të ankueses, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

a) Mbi legjitimitimin e ankueses

21. Në zbatim të nenit F, pika 2 e Kushtetutës, ankuesja legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin nr. 542, datë 20.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është shpallur në seancë publike më datë 20.06.2022. Vendimi i arsyetuar, nr. 542, datë 20.06.2022, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 05.08.2022, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 23.08.2022. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë, në datën 27.08.2022, pranë Komisionit, ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 542, datë 20.06.2022. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

b) Mbi formën e gjykimit të ankimit

22. Ankuesja ka paraqitur në ankimin drejtuar Kolegjit edhe kërkesën për gjykimin e çështjes së saj në seancë publike, pasi debati gjyqësor është i nevojshëm, për shkak të shkeljeve procedurale, si dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga Komisioni, duke kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor, me qëllim marrjen në shqyrtim dhe analizimin e provave të depozituara në dosjen e Komisionit, në funksion të konstatimit të gjendjes faktike dhe kryerjes së një analize të drejtë financiare.
23. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në rastin konkret, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se pretendon shkelje procedurale nga ana e Komisionit, nuk ka sjellë në ankim të dhëna konkrete për evidentimin e këtyre shkeljeve. Nga verifikimi i veprimtarisë procedurale të Komisionit gjatë hetimit administrativ dhe zhvillimit të seancave dëgjimore, nuk rezultojnë shkelje procedurale, që do të kërkonte, si pasojë, korrigjimin e tyre gjatë shqyrtimit të çështjes në

Kolegj. Ndërsa, për sa i përket kërkesës së ankueses për shqyrtimin dhe analizimin e provave, sillet në vëmendje se vlerësimi i provave dhe akteve të administruara gjatë procesit të zhvilluar në Komision është pjesë e qenësishme e procedurës së analizimit të shkaqeve të ankimit nga Kolegji. Për rrjedhojë, në kushtet kur nuk identifikohet plotësimi i asnjë prej kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012,¹ çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të ankueses ndaj vendimit të Komisionit nr. 542, datë 20.06.2022, duhet të merret në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

B. 1. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me statusin si subjekt rivlerësimi

24. Në shqyrtim të pretendimeve të ankueses, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se:

24.1. Znj. Brunilda Çarçiu (Ago) ka kryer studimet në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike në sistemin me shkëputje nga puna, në vitet akademike 1987 – 1991, dhe është diplomuar juriste në datën 05.07.1991.

24.2. Pas përfundimit të studimeve, ankuesja është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh, detyrë të cilën e ka mbajtur nga data 01.08.1991 deri në datën 15.05.2000, kur me vendimin nr. {***}, të ish-KLD-së, ajo lirohet nga detyra e gjyqtares me kërkesën e saj. Në datën 15.05.2000, është emëruar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 01.03.2011. Me Urdhrin nr. {***} prot., datë 09.05.2012, KLD-ja ka urdhëruar emërimin e znj. Brunilda Çarçiu si specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Inspektoratit të KLD-së.

24.3. Me vendimin nr. {***}, datë 18.11.2016, të KLD-së, znj. Brunilda Çarçiu është emëruar inspektore pranë IKLD-së.

24.4. Në datën 27.01.2017, znj. Brunilda Çarçiu, në funksionin e inspektore pranë KLD-së, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën *vetting*, si dhe dokumentacionin mbështetës. Në datën 30.01.2017, ajo ka depozituar formularin e vetëvlerësimit dhe dokumentet shoqëruese pranë KLD-së, si organ i vlerësimit të aftësive profesionale.

24.5. Me kërkesën e datës 10.4.2018, znj. Brunilda Çarçiu i është drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ONM-së, kryeinspektore së KLD-së dhe Shkollës së Magjistraturës, duke kërkuar t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar si ish-gjyqtare. Ankuesja bën me dije se kjo kërkesë është bërë prej saj, pasi Shkolla e Magjistraturës i ka kërkuar të kryejë testimin profesional, ndërkohë që ajo duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar, për shkak të detyrës si inspektore e KLD-së dhe njëkohësisht si ish-gjyqtare.

¹ Neni 51, pika 1, përcakton që: “[...] 1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë”.

24.6. Me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2019, KLGJ-ja, pasi ka arritur në përfundimin se inspektorja Brunilda Çarçiu e ka ruajtur statusin e gjyqtarit, ka vendosur të deklarojë pasjen e statusit “magjistrat” nga znj. Brunilda Çarçiu.

24.7. Me *email*-in e datës 08.10.2021, Komisioni i ka kërkuar ankueses informacion nëse ka paraqitur kërkesë për t’u rivlerësuar si ish-gjyqtare dhe, nëse po, të vendosë në dispozicion të Komisionit kërkesën e saj. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ankuesja ka informuar se: *Në lidhje me informacionin e kërkuar, po ju sqaroj se në momentin që ligji hyri në fuqi, unë nuk isha në detyrën e inspektore në KLD, pasi jam emëruar në këtë detyrë me vendimin nr. {***}, datë 18.11.2016. Në momentin që Gjykata Kushtetuese vendosi afatin përfundimtar për plotësimin e formularëve, mendova se isha pjesë e këtij ligji si inspektore tashmë në detyrë, dhe plotësova, në përputhje me këtë ligj, deklaratën vetting.*

24.8. Referuar akteve të Komisionit, rezulton se ankuesja, në përgjigje të kërkesës së Komisionit që të përcaktojë qartësisht qëndrimin përfundimtar lidhur me procesin e rivlerësimit, për konsiderimin apo jo si subjekt rivlerësimi, në datën 19.10.2021, nëpërmjet postës elektronike, ka parashtruar se: *deklaratat dhe formularin vetting i ka plotësuar në përputhje me nenin 179/b të Kushtetutës, ku parashikohet se inspektorët pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë i nënshtrohen rivlerësimit ex officio. Në këto kushte, edhe formulari i vetëdeklarimit pranë KLD-së është plotësuar si inspektore në detyrë, duke depozituar edhe procesverbalin nr. {***} prot., datë 30.1.2017, si dhe fletën e inventarit. Ky formular nuk është plotësuar si ish-gjyqtare, pasi si ish-gjyqtare duhej t’i drejtohej KLD-së me kërkesë. Plotësimi i deklaratës vetting prej saj si inspektore, tregon se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga procesi i rivlerësimit, pasi e ka plotësuar këtë detyrim ligjor në momentin e emërimit si inspektore, ndërsa qenien si subjekt apo jo i ligjit, e lë në çmim të Komisionit.*

25. Komisioni, në analizë të kuadrit ligjor si dhe të rrethanave faktike si më sipër, ka konstatuar se znj. Brunilda Çarçiu ka plotësuar formularët sipas ligjit nr. 84/2016, ka depozituar kërkesë, edhe pse në tejkalim të afatit ligjor, për t’u rivlerësuar si ish-gjyqtare. Gjatë hetimit administrativ, në qëndrimet e saj, është shprehur se nuk i është shmangur procesit të rivlerësimit, si dhe në komunikimin e saj me Komisionin, është shprehur se ka lënë në çmim të këtij institucioni rivlerësimin ndaj saj. Sipas Komisionit, të gjitha këto veprime qartësisht diktojnë vullnet të pavesuar dhe real lidhur me këtë proces. Vendimi i KLGJ-së për dhënien e statusit të magjistratit për znj. Brunilda Çarçiu i shtrin efektet prapavepruese nga momenti i emërimit si inspektore, duke e barazuar plotësisht me subjektet e tjera, përpara mbarimit të afatit për paraqitjen e formularëve, pikërisht për të mundësuar nisjen e procesit të rivlerësimit. Për këto arsye, Komisioni ka vlerësuar se zgjidhja më e përshtatshme dhe në përputhje me vullnetin e shprehur nga subjekti, me frymën e ligjit dhe me interesin publik, do të ishte kryerja e rivlerësimit për këtë subjekt.

26. Lidhur me sa pretendon ankuesja, në raport me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për statusin e saj si subjekt rivlerësimi, trupi gjykues analizon si vijon:

26.1. Në përcaktimin e statusit të ankueses, nëse konsiderohet apo jo subjekt rivlerësimi, duhet të merret në analizë vendimi nr. {***}, datë 19.12.2019, i KLGJ-së, si organi kushtetues që ka kompetencën ekskluzive për deklarimin e pasjes, mbarimit apo humbjes së statusit të

magjistratit / gjyqtarit. Në vendimin në fjalë, KLGj-ja ka konkluduar se inspektorja Brunilda Çarçiu e ka ruajtur statusin e gjyqtarit, prandaj asaj duhet t'i konfirmohet statusi i magjistratit. KLGj-ja ka arritur në këtë konkluzion, pasi ka konstatuar se: *duke qenë se inspektorja Brunilda Çarçiu ka kaluar menjëherë nga detyra e gjyqtares në atë të ndihmëses ligjore pranë Gjykatës së Lartë, ku gëzonte statusin e gjyqtarit, dhe më pas në detyrën e specialistes në administratën e ish-KLD-së, dhe të inspektore, ajo ka gëzuar statusin e gjyqtarit, për efekt të vjetërsisë në punë dhe pagës. [...] Për më shumë, vërtetohet se ajo, menjëherë pas mbarimit të afatit 10-vjeçar si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, ka bërë 7 kërkesa për emërimin e saj si gjyqtare në pozicionet e shpallura të lira, por ato nuk janë pranuar nga ish-KLD-ja, dhe nuk është përgjegjësia e saj që ajo nuk është kthyer të punojë në detyrën e gjyqtares, brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligji për komandimin në institucionet e tjera të drejtësisë. Fitimi i statusit të nëpunësit civil gjatë kohës që ajo ka punuar në ish-KLD nuk nënkupton humbjen automatike të statusit të gjyqtarit. Për këto arsye, KLGj-ja, me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2019, ka vendosur të deklarojë pasjen e statusit “magjistrat” për znj. Brunilda Çarçiu.*

26.2. Edhe Komisioni, duke referuar vendimin e KLGJ-së, ka konstatuar se: *Fakti që KLGJ-ja, si një organ kushtetues, ka disponuar me vendim se znj. Brunilda Çarçiu e ka ruajtur statusin e magjistratit, është konfirmuar, duke vlerësuar në këtë rast edhe depozitimin prej saj ndër vite, të shtatë kërkesave për t'u rikthyer në pozicion e gjyqtares, si dhe tri kërkesave për t'u emëruar si inspektore, duhet parë dhe çmuar nën analizën se ajo ka qenë dhe është në detyrë, sipas parashikimit të nenit 179/b të Kushtetutës, nën efektin e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, edhe në ecurinë e procesit të rivlerësimit.*

27. Sa më sipër, në referim të vendimit nr. {***}, datë 19.12.2019, të KLGJ-së, vendim i cili i shtrin efektet më pas në kohë, trupi gjykues vëren se në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, më datë 11.08.2016, znj. Brunilda Çarçiu nuk e kishte humbur statusin e gjyqtares, edhe pse nuk ishte e emëruar në detyrë. Pika 16 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ka parashikuar se: *“Subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës”,* dhe neni 179/b i Kushtetutës, në pikat 3 dhe 4 ka parashikuar se: *3. Të gjithë gjyqtarët [...] i nënshtrohen rivlerësimit ex officio. 4. [...] Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët [...] të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. Pika 3 e nenit 179/b të Kushtetutës i referohet të gjithë gjyqtarëve të cilët e mbajnë statusin e magjistratit / gjyqtarit në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ndërsa fjalia e dytë e paragrafit 4 i referohet ish-gjyqtarëve që nuk e kanë statusin, por kanë punuar të paktën tre vjet në këto pozicione dhe, nëpërmjet kërkesës, pasi të kalojnë procesin e rivlerësimit, mund të rikthehen në sistem, pra diferenca midis cilësisë së gjyqtarit dhe ish-gjyqtarit është statusi i magjistratit në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave. Në rastin konkret, në kushtet kur ankuesja, sipas vendimit të KLGJ-së, e ka pasur statusin e magjistrates në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, megjithëse nuk ka qenë në ushtrim të funksionit, ajo i përkiste kategorisë së gjyqtarëve dhe jo të ish-gjyqtarëve, siç pretendon në ankim. Pavarësisht sjelljes procedurale të ankueses, e cila gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit ka pasur pretendime të ndryshme për statusin e saj në faza të ndryshme të procesit, rëndësi ka fakti që, për shkak të Kushtetutës dhe ligjit të kohës, znj. Brunilda Çarçiu, referuar vendimit të KLGJ-së, e mbartte statusin e magjistrates / gjyqtares që nga momenti që ishte emëruar në detyrën e gjyqtares, pra që në vitin*

1991. Pasja e statusit të magistrates në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, i jep asaj cilësinë e “magjistrates / gjyqtares”, dhe e bën në mënyrë të drejtpërdrejtë subjekt të ligjit nr. 84/2016, që bie nën parashikimin e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, duke e përjashtuar në mënyrë automatike cilësinë e saj si ish-gjyqtare. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se është i pabazuar pretendimi i ankueses se, për shkak të faktit se nuk ka paraqitur kërkesë si ish-gjyqtare në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, nuk mund të konsiderohet si subjekt rivlerësimi.

28. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se ankuesja, në mënyrë të vazhdueshme, ka paraqitur kërkesa ndaj KLD-së për kthimin në detyrë si gjyqtare, fakt që konfirmon vullnetin e saj për të vazhduar të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë, pavarësisht se kërkesat e saj nuk u trajtuan nga organet që kishin detyrimin ligjor të zbatimit të ligjit të kohës. Ky qëndrim konfirmohet edhe në qasjen që ajo ka pasur në fillim të procesit të rivlerësimit, duke dorëzuar deklaratën *vetting* dhe plotësuar deklaratat e tjera të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016. Konstatohet se, vetëm me fillimin e procesit dhe plotësimin e detyrimeve në kuadër të tij, ankuesja ka ndryshuar qëndrimin duke kërkuar fillimisht, pasi i është kërkuar testimi në Shkollën e Magjistraturës, të trajtohet si ish-gjyqtare, dhe më pas duke ndryshuar përsëri qëndrim, ka pretenduar se *deklaratat dhe formularin vetting i ka plotësuar si inspektore në detyrë dhe jo si ish-gjyqtare*. Me këtë argument të fundit, ankuesja, duke pretenduar se nuk ka qenë në funksionin e inspektore në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, dhe nuk ka paraqitur as kërkesë si ish-gjyqtare, ka kërkuar nga Komisioni që të mos konsiderohet subjekt rivlerësimi, ndërkohë që gjatë shqyrtimit të çështjes së saj në Komision, ajo e kishte të konfirmuar statusin e saj si magjistrate/gjyqtare, sipas vendimit të datës 19.12.2019, të KLGJ-së. Të gjitha këto veprime të ankueses hedhin poshtë edhe pretendimin e saj se nuk ka dashur t’i shmangët procesit të rivlerësimit dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij.
29. Në përfundim, në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ankuesja, nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore në fuqi, është subjekt rivlerësimi, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, ajo gëzonte statusin e gjyqtares dhe u përfshi në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, si të tillë. Ankuesja, për shkak të ruajtjes së statusit të gjyqtares, konfirmuar edhe me vendimin nr. {***}, të datës 19.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të shprehjes së vullnetit për t’u rikthyer në sistemin e drejtësisë, konsiderohet *subjekt rivlerësimi* dhe duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016.

B. 2. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me procesin e rregullt

30. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankimin drejtuar Kolegjit se procesi i rivlerësimit ndaj saj nuk u krye nga një “gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj”, siç kërkohet nga neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Sipas subjektit të rivlerësimit, përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit është bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga GjEDNJ-ja në çështjen “Oleksandr Volkov kundër Ukrainës”, që përcaktojnë nëse një organ, që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, është një organ i pavarur dhe i paanshëm. Sipas këtyre kriterëve, kërkohet një përfaqësim thelbësor i gjyqtarëve brenda organit disiplinor, ndërkohë që rezulton se asnjë prej anëtarëve të Komisionit nuk ka ardhur nga gjyqësori në

momentin e emërimit. Anëtarët e Komisionit janë zgjedhur nga një komitet *ad hoc* parlamentar, me një procedurë që ka shumë defekte, dhe pa përfshirjen e trupës gjyqësore. Sipas subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen e saj nuk plotëson kriteret e një gjykate të krijuar me ligj, pasi disa nga anëtarët nuk përmbushin kërkesat e përzgjedhjes, të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016.

30.1. Në përgjigje të sa më sipër, sillet në vëmendje se ky pretendim lidhet me organizimin dhe funksionimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit, që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht. Përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve të rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së, në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë, është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, si dhe çështja e gjykatës së krijuar me ligj është konfirmuar nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNJ-ja, në vendimin që i përket “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”,² në konkluzionin se institucionet e krijuara për të kryer rivlerësimin përmbushin garancitë e sanksionuara nga neni 6 i KEDNj-së, për sa i përket gjykatës së krijuar me ligj. Në të njëjtën mënyrë ka konkluduar edhe Kolegji në jurisprudencën e deritanishme³, në analizën e pretendimeve të ngjashme nga subjekte të tjera rivlerësimi. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se procesi i rivlerësimit të saj nuk është kryer nga një gjykatë e krijuar me ligj, për shkak të faktit që komisionerët nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit, është i pabazuar.

30.2. Për sa u përket pretendimeve për procedurën dhe përputhshmërinë me kriteret ligjore të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit, sillet në vëmendje qëndrimi i Kolegjit se: *[...] për natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit, që në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'i nënshtrohet disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve, edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar, të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin është shoqëruar me garanci, që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t'i lihej rastësisë, do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNJ-ja, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës, kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, konsiderohen të adresuara nga*

² Paragrafët 280 - 288 të vendimit të GjEDNJ-së, *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

³ *Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nr. 19/2022 (JR), për subjektin e rivlerësimit Anila Guri; nr. 54/2023 (JR), për subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj; nr. 49/2025 (JR), për subjektin e rivlerësimit Çlirim Sino.*

kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj⁴. [...] Përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit është kryer mbi një vullnet të gjerë të ligjvënësit dhe e mbështetur plotësisht nga dispozitat kushtetuese e ligjore, që i përgjigjej kërkesës imediate të vendit për kryerjen e procesit kalimtar të rivlerësimit. Qëllimi i zgjedhjes në bllok të anëtarëve nuk duhet interpretuar si cenim i parimeve për një proces të rregullt, por si një garanci në ngritjen e këtyre institucioneve dhe në pacenueshmërinë e anëtarëve të tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Në të kundërt, veprimtaria e këtyre organeve do të ishte lehtësisht e ndikueshme nga mjete ankimi apo kontrolli rreth kushteve të vlefshmërisë, të cilat logjikshëm do të përdroreshin për këtë qëllim prej subjekteve të rivlerësimit. Vlen të sillej në vëmendje se procesi i rivlerësimit kalimtar ishte një nevojë për t'iu përgjigjur dhe ndalur korrupsionin endemik të konstatuar se ekzistonte në sistemin e drejtësisë në vend, nga faktorët e brendshëm, por edhe organizmat ndërkombëtarë. Rikthimi i besimit te sistemi i drejtësisë u konceptua si një qëllim i vështirë për t'u arritur dhe për të cilin duhej të zbatoheshin masa të jashtëzakonshme dhe, mbi të gjitha, anëtarët e zgjedhur me konsensus dhe që merrnin përsipër kryerjen e tij, të kishin të garantuar qenien në detyrë, të fituar nëpërmjet një mekanizmi të posaçëm kushtetues dhe të pakontestueshëm si të tillë.⁵

30.3. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se janë të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së në procesin e rivlerësimit të zhvilluar në Komision.

31. Lidhur me pretendimin se mosaplikimi i parimit kushtetues të dyfishit të pasurisë së ligjshme cenon parimin e sigurisë juridike, Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar⁶, nëpërmjet së cilës ka shtjelluar rëndësinë që kanë saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë, për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në analizë të interpretimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka vlerësuar që secili prej paragrafëve të këtij neni normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve, me elemente specifike dhe të pavarura, të cilët zbërthehen në përcaktimin e masave disiplinore, sipas pikave 1 dhe 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ndër to, respektivisht i pari lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme, ndërsa tjetri me pamjaftueshmërinë e deklarimit të pasurisë, dhe për sa kohë Komisioni ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, duke e kualifikuar situatën sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mosaplikimi i parimit kushtetues të dyfishit të pasurisë së ligjshme cenon parimin e sigurisë juridike është i pabazuar.

⁴ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nr. 43/2022 (JR), për subjektin e rivlerësimit Hajrie Muçmata, dhe nr. 48/2022 (JR), për subjektin e rivlerësimit Ervin Trashi.

⁵ Shih vendimin e Kolegjit, nr. 3/2023 (JR), për subjektin e rivlerësimit Tritan Hamitaj.

⁶ Shih vendimet e Kolegjit, nr. 7/2019 (JR), për subjektin e rivlerësimit Elision Sadiku; nr. 19/2019 (JR), për subjektin e rivlerësimit Xhezair Zaganjori; nr. 13/2020 (JR), për subjektin e rivlerësimit Ana Gollosi; nr. 25/2021 (JR), për subjektin e rivlerësimit Artor Ylli; nr. 34/2021 (JR), për subjektin e rivlerësimit Isuf Shehu; nr. 19/2022 (JR), për subjektin e rivlerësimit Anila Guri; nr. 6/2024 (JR), për subjektin e rivlerësimit Olsi Xhavella.

B. 3. Analiza e pretendimeve mbi vlerësimin e pasurisë

- Për pasurinë “banesë private 2 kate”, në bashkëpronësi, në Tiranë

32. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Banesë private 2 kate, në bashkëpronësi, me sipërfaqe takuese $\frac{1}{4}$, ndodhur në Laprakë, e vetëndërtuar pjesë-pjesë që në vitin 1996, e vlerësuar sipas çmimeve të kohës, legalizuar me lejen e legalizimit nr. {***}, datë 19.12.2014, me sipërfaqe trualli 568.40 m², sipërfaqe ndërtimi 243.90 m², sipas certifikatës së pronësisë me nr. serial {***}, z. k. nr. {***}, nr. pasurie {***} dhe dokumentet bashkëlidhur. Vlera: 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshortin, e pjesës takuese prej 25%. Burimi i krijimit: kursime nga pagat në vite dhe të ardhura nga aktivitet privat”.

32.1. Komisioni ka çmuar si vlerë investimi të banesës shumë prej 3.000.000 lekësh, referuar fakteve e rrethanave se: (i) ka mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor që të tregojë vlerën e investimeve; (ii) subjekti ka deklaruar në mënyrë konsistente si vlerë të pasurisë shumë prej 3.000.000 lekësh, duke filluar me deklaratën vjetore të interesave privatë (në vijim “DPV”) për vitin 2003, dhe vijuar me deklaratën para fillimit të detyrës, të datës 18.11.2016, dhe deklaratën vetting; (iii) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja më datë 07.02.2017, ka deklaruar se vlera e shpenzuar për pjesën e tij takuese në banesë ka qenë 3.000.000 lekë; (iv) pretendimi i subjektit të rivlerësimit se i është referuar vlerës së tregut nuk qëndron, pasi vlera e tregut ka qenë dy herë më e lartë se vlera prej 3.000.000 lekësh.

32.2. Sa u përket burimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për investimin në banesë, Komisioni ka çmuar të konsiderojë në analizën financiare të ardhura të ligjshme nga aktiviteti privat i vjehrrit, në shumë prej 393.336 lekësh, e cila përbëhet nga paga minimale, e përcaktuar sipas VKM-ve të viteve 1993 – 1997. Për sa u përket të ardhurave të bashkëshortit si ekspert kontabël në vitin 1997, Komisioni çmoi se ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe nuk i ka përfshirë ato në analizën financiare.

32.3. Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare për justifikimin e investimit në banesë të vlerës 3.000.000 lekë. Nga kjo analizë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti rezultojnë me pamundësi financiare në vlerën prej (-) 206.928 lekësh. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i konsiderimit të periudhës së ndërtimit, e shtrirë nga viti 1997 deri në fund të vitit 2000, çka ka sjellë përfshirjen e të ardhurave familjare të subjektit edhe për periudhën pas marsit të vitit 1997, dhe përfshirjes së disa prej të ardhurave të vjehrrit dhe vjehrrës së subjektit të rivlerësimit.

32.4. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, kundërshton konkluzionin e Komisionit për balancën negative dhe pretendon se vlera e kostos së banesës së ndërtuar deri në fund të vitit 2000 është 1.727.494 lekë, sipas kostos së ndërtimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”), duke zbritur vlerën e zërave të kostove që nuk kryhen në ndërtimet informale.

32.5. Për sa u përket burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit kërkon në ankim që të përfshihen në analizën financiare edhe të ardhurat nga aktiviteti privat i vjehrrit (z. R. Ç.) për periudhën 1993 – 1999, të cilat duhet të përllogariten të paktën në vlerën

606.720 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kërkon që të konsiderohet si e ardhur e ligjshme dhe të përfshihet në analizën financiare, edhe vlera prej 630.000 lekësh, e përfituar në vitin 1997 nga aktiviteti i bashkëshortit si ekspert kontabël i autorizuar.

32.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshton edhe llogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën deri në vitin 1999 nga Komisioni, pasi sipas saj, këto shpenzime kanë qenë më të ulëta, për shkak se një pjesë e shpenzimeve familjare mbulohej nga produktet e përfituara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në pronësi të vjehrrit të saj. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit pretendon se shpenzimet jetike të periudhës duhet të reduktohen edhe me 40% të vlerës, që është llogaritur si 30% e të ardhurave, dhe jo vetëm me 30%, për shkak të pagave të larta, siç ka konsideruar Komisioni.

32.7. Në përfundim, për pasurinë “banesë private 2 kate”, në bashkëpronësi, e ndodhur në Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur burime të ligjshme financiare për të përballuar koston e ndërtimit në vitet 1996 – 2000, pasi deri në fund të vitit 2000, rezulton me mundësi kursimi në vlerën 2.466.340 lekë.

33. Lidhur me këtë pasuri, nga aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

33.1. Sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.10.1996, shtetasi S. Ç., kunati i subjektit të rivlerësimit, dhe shtetasi Sh. K., kanë blerë godinën 1 kat, ish-{***} Laprakë, në vlerën 1.500.000 lekë.

33.2. Nga dokumentet hipotekore të lëshuara më datë 14.10.2003, nga ZVRPP-ja Tiranë, vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. {***}, ZK {***}, datë 30.10.1996, figuron e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve S. Ç. dhe Sh. K., një godinë njëkatëshe, ish-{***} e Laprakës, e ndodhur brenda territorit të stacionit pranë {***} Laprakë, me sipërfaqe truallit të objektit 1.067 m².

33.3. Sipas kontratës për pjesëtim vullnetar, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.02.2000, kunati i subjektit të rivlerësimit, z. S. Ç., ka marrë pjesën “A” të objektit, ku ndodhej godina 1 kat, ish-{***}, dhe sipërfaqen e truallit prej 567 m², ku është ndërtuar prej 4 bashkëpronarëve, S. Ç., A. Ç., A. A. dhe A. Ç., banesa objekt shqyrtimi.

33.4. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi origjinën dhe mënyrën e përfitimit të truallit mbi të cilin ndodhet objekti, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep, nr. {***} kol., datë 30.10.1996 shtetasit S. Ç. dhe Sh. K. kanë blerë në vlerën 1.500.000 lekë një godinë 1 kat, ish-{***} Laprakë, ndërsa sipërfaqja prej 1.067 m² u është dhënë me qira për pesë vjet, sipas vërtetimit të pronësisë, të datës 16.01.1997. Sipas kësaj kontrate, që subjekti e ka vënë në dispozicion dhe vërtetimit të pronësisë së objektit, rezulton se truallit i objektit është dhënë me qira, që është paguar deri në datën 19.09.1997. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, pavarësisht përpjekjeve për të përfituar truallin poshtë ndërtesës, nuk është bërë e mundur blerja e truallit me sipërfaqe 567 m² dhe, për këtë arsye, pronësia mbi këtë truall është fituar bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin”. Lidhur me përfitimin e truallit nga bashkëshorti, subjekti i

rivlerësimit ka sqaruar se vëllai i bashkëshortit ka pranuar që në truallin e objektit të blerë prej tij (pjesën e tij takuese), në fund të vitit 1996, të ndërtonin, përveç tij, edhe dy vëllezërit e tjerë.

33.5. Me shkresë “kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 25.02.2020, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, ka informuar se në emër të shtetasit A. R. Ç., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, rezulton e regjistruar në bashkëpronësi me A. T. A. (babai i subjektit), A. R. Ç. (vëllai i bashkëshortit të subjektit) dhe S. R. Ç. (vëllai i bashkëshortit të subjektit), pasuria e llojit “truall me sip. 568.4 m²”+ “ndërtesë me sip. 243.9 m²”, në ZK {***}, me leje legalizimi.

33.6. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi gjendjen juridike aktuale të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka informuar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 se, pas pjesëtimit të bashkëpronësisë, është regjistruar më datë 26.04.2021 në pronësi të A. Ç.: (i) pasuria nr. {***}, ZK {***}, e llojit “apartament me sipërfaqe 57.98 m²”; (ii) pasuria nr. {***} e llojit “apartament me sipërfaqe 65.78 m²”, pra në pronësi të z. A. Ç. rezultojnë dy apartamente, me sipërfaqe totale 123.76 m².

34. Për sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për vlerën e investimit në banesë, konstatohet se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, ajo e ka deklaruar në vlerën 3.000.000 lekë, me burim “të ardhurat nga biznesi i vogël në Gramsh”, si dhe “të ardhurat familjare”. Edhe në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2016, si dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjtën vlerë prej 3.000.000 lekësh për ndërtimin në pjesën takuese të banesës dykatëshe.

34.1. Në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të datës 07.02.2017, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *Qartësoj se nuk kemi paguar për blerjen e sipërfaqes së truallit, por unë, për pjesën time të banesës, kam shpenzuar shumë 3.000.000 lekë, sipas situacionit të punimeve nga Ing. D. S. dhe fotove, me fonde të siguruara nga të ardhurat nga paga dhe nga ushtrimi i aktivitetit si ekspert kontabël.* Në kushtet kur këto akte nuk kanë qenë pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacion ligjor si: situacion punimesh / preventiv punimesh, akt kolaudimi, kontratë ndërtimi etj., për ndërtimin e shtëpisë së banimit 2 kate, për vlerën e deklaruar 3.000.000 lekë. Nga aktet, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në Komision asnjë provë shkresore për të vërtetuar sasinë e punimeve ndër vite apo vlerën e investimeve të kryera në banesë.

34.2. Komisioni ka konstatuar se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se ka deklaruar vlerën e investimit sipas çmimeve të tregut, pasi vlera e tregut, bazuar në çmimin e referencës sipas EKB-së, për blerjen e një apartamenti në qytetin e Tiranës për vitin 2003, ka qenë 53.450 lekë/m², çka bën që vlera e dy apartamenteve të subjektit, në rast se do t'i shiste ato, do të ishte 6.614.972 lekë.

34.3. Komisioni, në përfundim, në kushtet kur ka pasur mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor që të tregojë vlerën e investimeve, dhe bazuar në deklaratimet konsistente të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*, për vlerën prej 3.000.000 lekësh të investimit, ka çmuar si vlerë investimi të banesës shumë prej 3.000.000 lekësh.

34.4. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, duke parashtruar të njëjtat argumente si në Komision, pretendon se vlerën e banesës e ka deklaruar sipas një vlerësimi subjektiv, referuar vlerës së tregut në momentin e deklarimit në vitin 2003. Sipas subjektit, rezultojnë qartësisht se ndërtesa është ndërtuar në mënyrë informale dhe, në këto kushte, nuk ka një vlerë të mirëpërcaktuar për krijimin e kësaj pasurie, por bazuar në praktikën vendimmarrëse të trupave të rivlerësimit, vlera e investimit mund të përlllogaritet me metoda alternative.

34.5. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit kërkon që vlera e investimit në banesën dykatëshe të llogaritet sipas kostove të përcaktuara nga EKB-ja, dhe jo bazuar në vetë deklaratat e saj dhe të bashkëshortit në deklaratat e pasurisë së viteve 2003 dhe 2016, në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 07.02.2016, si dhe në deklaratën *vetting*. Këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit e ka ngritur për herë të parë gjatë procesit në Komision, vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit, në të cilat Komisioni ka konstatuar se: *edhe nëse do të kryheshin përlllogaritjet sipas variantit të deklarimeve të subjektit, se banesa është ndërtuar në vitet 1996 – 2000, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë qenë në pamundësi financiare për të justifikuar vlerën prej 3.000.000 lekësh, për shkak të një balance negative prej (-) 1.783.533 lekësh*. Nga verifikimi i përgjigjeve të 5 pyetësorëve, që i janë dërguar subjektit të rivlerësimit, rezultojnë se në asnjë prej tyre, ajo nuk ka kundërshtuar vlerën e investimit prej 3.000.000 lekësh, por vetëm ka dhënë sqarime lidhur me punimet që kanë qenë informale, pa sjellë asnjë dokumentacion për të provuar vlerën e këtyre punimeve. Vetëm në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dalë me pretendimin se, në kushtet kur ndërtesa është ndërtuar në mënyrë informale dhe nuk kanë pasur mundësi të deklarojnë një vlerë ekzakte për koston e ndërtimit të kësaj banese, vlera e koston së banesës së ndërtuar deri në fund të vitit 2000, sipas kostove të miratuara nga EKB-ja për vitet 1997 – 2000, është në shumën 1.727.494 lekë.

34.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshton edhe qëndrimin e Komisionit, sipas të cilit, deklaratat e subjektit për vlerën e investimit janë gjetur konsistente. Sipas subjektit, Komisioni, në deklaratën e saj në deklaratën *vetting*, duhet të kishte vlerësuar togfjalëshin *vlerësuar sipas çmimit të kohës*, që tregon se ajo ka deklaruar çmimin me të cilin ka menduar se vlerësohej pasuria në kohën e deklarimit dhe jo koston e ndërtimit. Trupi gjykues vëren se, përveç faktit se, ashtu si edhe ka konstatuar Komisioni, vlera e tregut në vitin 2003 ka qenë dyfish e lartë, ky pretendim është i pabazuar, edhe për faktin se, sipas parashikimeve ligjore, si në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, ashtu dhe në deklaratën *vetting*, deklarohet vlera reale e pasurisë dhe jo vlera që ajo do të kishte sipas tregut të kohës. Në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, në rubrikën e deklarimit të pasurive përcaktohet se, për çdo pasuri duhet të jepet vlera që pasqyrohet në dokumentacion, çmimi i blerjes dhe, në mungesë të dokumenteve, shuma e shpenzimeve të kryera. Ky pretendim i subjektit kundërshtohet edhe nga vetë deklaratat e bashkëshortit të saj në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 07.02.2016 se, *për pjesën time të banesës, kam shpenzuar shumën 3.000.000 lekë, sipas situacionit të punimeve*.

34.7. Trupi gjykues, për sa rezultojnë më sipër, vlerëson se deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë, për vlerën e investimit 3.000.000 lekë, përbëjnë provë, në kuptim të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016 dhe, së bashku me deklaratat në ILDKPKI dhe në deklaratën *vetting*, kanë një peshë më të madhe se deklaratat e mëpasshme gjatë procesit të rivlerësimit, bazuar edhe në faktin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të sjellë asnjë akt / provë

për të vërtetuar pretendimet për një vlerë më të ulët të investimit. Për rrjedhojë, mbetet i bazuar konkluzioni i Komisionit se vlera e investimit në banesën dykatëshe është në vlerën 3.000.000 lekë.

35. Për sa u përket burimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, që kanë shërbyer për kryerjen e investimit në ndërtimin e banesës, trupi gjykues vlerëson se, në ankimin drejtuar Kolegjit, ajo kundërshton mospërfshirjen në analizën financiare e të ardhurave nga aktiviteti privat i vjehrrit, të cilat duhet të jenë në vlerën 606.720 lekë, sipas saj, për periudhën 1993 – 1999. Komisioni ka konsideruar si të ardhura në këto vite vetëm pagën minimale të kohës. Sipas subjektit të rivlerësimit, vjehri i saj ka ushtruar aktivitetin privat si shitës në fshatin Drizë, por për shkak të situatës së vitit 1997, nuk ka mundur të sigurojë dokumentacionin për ushtrimin e aktivitetit dhe të ardhurat e realizuara. Sipas subjektit, në kushtet kur provohet regjistrimi në organet tatimore, duhet të prezumohet të paktën niveli minimal i të ardhurave dhe, mbi bazën e këtij niveli, të llogariten të ardhurat e realizuara në vlerën 606.720 lekë, për periudhën 1993 – 1999.

35.1. Për të provuar aktivitetin tregtar të vjehrrit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision aktet: (i) certifikatë / licencë ushtrimi profesioni, nr. {***}, lëshuar më datë 29.07.1993, sipas së cilës vërtetohet se shtetasi R. Ç. ka ushtruar veprimtari private si shitës në një lokal në fshatin Drizë, sipas vendimit nr. {***}, datë 27.07.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 16.01.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; (iii) vërtetim i datës 02.03.2022, i kryetarit të fshatit Drizë, Gramsh, i cili vërteton faktin e ushtrimit të aktivitetit nga z. R. Ç. për vitet 1993 – 1997, dhe se njësia e shitjes së tij ka qenë e vetme për zonën; (iv) vendim i Gjykatës së Rrethit Gramsh, nr. {***}, datë 28.07.1995, vërtetim fakti për ndërtimin prej kërkuesit, R. Ç., të një dyqani në truallin në pronësi të tij, pranë banesës.

35.2. Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 16.01.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, subjekti tregtar R. Ç., për periudhën 29.07.1993 deri më 31.08.1999, ka qenë i regjistruar, por për shkak të situatës së vitit 1997, nuk disponohet dokumentacion për këtë subjekt.

35.3. Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhura konkrete nga aktiviteti i vjehrrit gjatë viteve 1993 – 1997, ndërsa nuk e ka gjetur të bazuar në asnjë provë e dokument pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive për vitet 1998 dhe 1999. Për këtë arsye, Komisioni ka çmuar të konsiderojë në analizën financiare për ndërtimin e banesës, të ardhura të ligjshme nga aktiviteti privat i vjehrrit, vlerën prej 393.336 lekësh, e cila përbëhet nga paga mesatare, e llogaritur sipas pagës minimale dhe maksimale të përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave (në vijim “VKM”), të viteve 1993 – 1997.

35.4. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se ka pretenduar të ardhura të realizuara nga aktiviteti privat i vjehrrit për periudhën 1993 – 1998, nuk ka arritur t’i provojë ato, të paktën për vitet 1998, 1999, që vijnë pas ngjarjeve të vitit 1997. Komisioni, duke mbajtur në konsideratë situatën e vitit 1997, ka konsideruar që subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion për periudhën para këtij viti. Nga këto rrethana, në kushtet kur provohet ushtrimi i aktivitetit tregtar nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, por në mungesë të dokumentacionit provues, trupi gjykues

e vlerëson të bazuar qëndrimin e Komisionit, i cili për periudhën 1993 – 1997 ka konsideruar të ardhurat nga aktiviteti privat i vjehrrit në vlerën prej 393.336 lekësh, referuar pagës mesatare së përcaktuar nga VKM-të për këtë periudhë.

36. Për sa i përket burimit tjetër të deklaruar për kryerjen e investimit në banesën dykatëshe, të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si ekspert kontabël, rezulton se në deklaratën *vetting*, ai ka deklaruar të ardhura si ekspert kontabël i autorizuar, për vitin 1997, në vlerën 360.000 lekë. Në pyetësin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *bashkëshorti, për vitin 1997 ka qenë i pajisur me licencë të përkohshme si ekspert kontabël i autorizuar, ndërkohë që ushtronte detyrën e përgjegjës të seksionit të financës në Bashkinë Gramsh. Bazuar në shkresën e degës së Tatim- Taksave Gramsh, nr. {***}, datë 05.03.1997, i është kërkuar, sipas ligjit, që të bëjë ekspertimin kontabël të bilanceve të subjekteve të vitit 1996, qofshin këto shtetërore apo private, të cilat plotësonin kushtet ligjore për ekspertim. Me shkresën nr. {***}, datë 16.01.2020, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, pasi kërkuam informacion për të ardhurat dhe fitimet e realizuara për këtë subjekt, përgjigjja e tyre është: për shkak të situatës së vitit 1997, nuk disponojnë dokumentacion për këtë subjekt. Sipas përlllogaritjeve të subjekteve të ekspertuar, kemi deklaruar të ardhura në shumën 360.000 lekë. Në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, nga 18 subjekte të ekspertuara në vitin 1997, nëse konsiderohet që të paktën 13 prej tyre të jenë ekspertuar me honoraret minimale $13 \times 30.000 = 390.000$ lekë, plus 240.000 lekë pagesa nga pesë subjektet e tjera të referuara, nga aktiviteti i bashkëshortit në vitin 1997, rezulton një vlerë të ardhurash prej 630.000 lekësh.*

36.1. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision bashkë me pyetësorët aktet: (i) vendim nr. 5, datë 15.03.1994, “Për krijimin e grupit të ekspertëve kontabël të pavarur”; (ii) tri raporte auditimi për vitin ushtrimor 1996, të kryera nga bashkëshorti i subjektit; (iii) shkresë nr. {***} prot., datë 16.01.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan (në vijim “DRT”), sipas të cilës, nuk disponohet asnjë e dhënë për z. A. Ç., për vitet 1997 – 1998; (iv) licencë e përkohshme, nr. {***}, datë 15.01.1997, dhënë z. A. Ç., për ushtrimin e profesionit të ekspertit kontabël, me vlefshmëri deri më datë 31.05.1997; (v) shkresë nr. {***} prot, datë 05.03.1997, nga Dega e Tatim-Taksave Gramsh, mbi listat e subjekteve që do t’i nënshtrohen kontrollit nga ana e ekspertëve kontabël, për bilancet e vitit 1996. Kjo shkresë liston 18 subjekte dhe xhiron e parashikuar të tyre, të cilat i njoftohen ekspertit A. Ç. për kontroll.

36.2. Komisioni ka çmuar se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen të ligjshme për vitin 1997, bazuar në rrethanat: i) nuk është provuar fakti nëse bashkëshorti i subjektit ka kryer auditimin e 18 subjekteve tregtare dhe, për më tepër, të ketë marrë pagesë nga ky auditim. Përlllogaritja nga ana e subjektit, e shpërblimeve të marra nga bashkëshorti, tregon shumën e të ardhurave që do të duhej të ishte përfituar, por nuk e provon këtë përfitim; ii) duke qenë funksionar publik, bashkëshorti nuk ka qenë i regjistruar, pasi nuk mund të regjistrohej si subjekt tregtar / profesion i lirë në organet tatimore, për të ushtruar profesionin e ekspertit kontabël; iii) në rast se do të merrej e mirëqenë se këto të ardhura janë përfituar, pavarësisht se ato janë atipike, mbi to do të duhej të ishte paguar tatim në burim, në bazë të legjislacionit tatimor. Pagesa e tatimit në burim nuk mund të prezumohet si e kryer, për shkak se detyra është urdhëruar nga organi tatimor, për më tepër, në kushtet kur subjekti as nuk ka pretenduar dhe as

ka dhënë ndonjë shpjegim nëse është kryer kjo pagesë; dhe kur; iv) subjekti nuk provoi të jetë në kushtet e pamundësisë objektive, pasi vërtetimi i lëshuar nga DRT-ja Gramsh, se kjo drejtori *nuk disponon asnjë të dhënë*, pa dhënë asnjë arsye të shkaqeve, përafrohet më shumë me përshkrimin e situatës reale të z. A. Ç., pra që nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore, pasi nuk mund të regjistrohej, për shkak se ishte punonjës i administratës shtetërore.

36.3. Në ankimin drejtuar Kolegjit, ashtu si dhe gjatë procesit të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit pretendon se bashkëshorti i saj është urdhëruar që të bëjë ekspertimin kontabël të bilanceve të vitit 1996 nga DRT-ja Gramsh, çka vërteton faktin se ka qenë i regjistruar në organet tatimore dhe ka përmbushur detyrimet tatimore, pasi vetë autoriteti që ka detyrimin ligjor që të kontrollojë pagesën e detyrimeve tatimore e ka ngarkuar me kryerjen e këtij funksioni, prandaj, për këtë arsye, pagesa e detyrimeve tatimore duhet të prezumohet. Subjekti i rivlerësimit parashtron se është në pamundësi objektive për të provuar me dokumentacion të ardhurat dhe fitimet e realizuara prej bashkëshortit të saj dhe, për këtë arsye, i ka përlogaritur ato në vlerën 630.000 lekë, bazuar në legjislacionin e kohës, VKM-në nr. 896, datë 30.12.2006. Sa i takon pagesës së tatimit mbi të ardhurat si ekspert kontabël, subjekti i rivlerësimit pretendon se pagesën e tatimit në burim e bën personi që përfiton shërbimin, ndërkohë që në vitin 1997 nuk ka qenë i miratuar as ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Sipas subjektit, derisa auditimi është bërë me urdhër të organit që ka si detyrë kontrollin e pagimit të tatimeve, pagesa e detyrimeve tatimore duhet të prezumohet. Për këto arsye, subjekti pretendon se shuma prej 630.000 lekësh duhet të përfshihet si burim i ligjshëm në analizën financiare për ndërtimin e banesës.

36.4. Trupi gjykues vëren se, është i pabazuar pretendimi se ka qenë në kushtet e pamundësisë për të sjellë dokumentacionin që vërteton përfitimin e të ardhurave, për shkak se bëhet fjalë për të ardhura të përfituara në vitin 1997, dhe se nuk ka qenë përgjegjësi e saj dhe bashkëshortit, mosruajtja e dokumentacionit nga institucionet shtetërore përgjegjëse. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit i referohet shkresës nr. {***} prot., datë 16.01.2020, të DRT-së Elbasan, në të cilën ky institucion informon se, pasi janë bërë verifikimet në sistemin informatik të tatimeve apo në çdo informacion dokumentar për periudhën 1997 – 1998, nuk disponohet asnjë e dhënë për z. A. Ç.. Trupi gjykues vëren, ashtu si ka konstatuar edhe Komisioni, se ky vërtetim i lëshuar nga organet tatimore nuk referon për pamundësi të vënies në dispozicion të dokumentacionit, por për mungesë të dhënash në sistemin e tatimeve, për shkak se bashkëshorti i subjektit, ashtu si dhe e ka pranuar vetë, nuk ka qenë i regjistruar për ushtrimin e aktivitetit si ekspert kontabël i licencuar. Për rrjedhojë, rezultojnë të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se është në kushtet e pamundësisë objektive për të sjellë dokumentacionin që provon përfitimin e të ardhurave, në kushtet kur ky dokumentacion nuk mund të ketë ekzistuar.

36.5. Për të provuar kryerjen e aktivitetit si ekspert kontabël nga bashkëshorti, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një listë të subjekteve tregtare që do të auditoheshin prej tij, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 05.03.1997, të Degës së Tatim - Taksave Gramsh. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision edhe tri raporte auditimi për vitin ushtrimor 1996, të kryera nga bashkëshorti për tri shoqëri tregtare. Nga të gjitha këto akte, si nga lista e subjekteve tregtare, ashtu dhe nga raportet e auditimit, nuk jepet asnjë e dhënë për të ardhurat që ka përfituar bashkëshorti i subjektit për punën e kryer.

36.6. Trupi gjykues konstaton se, është i pabazuar edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti nuk ka pasur detyrimin për të paguar tatimin në burim për të ardhurat si ekspert kontabël. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, për shkak të aktivitetit si ekspert kontabël, këto të ardhura nuk duhet të trajtohen si të ardhura për të cilat paguhet tatim në burim. Konstatohet se Komisioni me të drejtë ka mbajtur këtë qëndrim, pasi është provuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore si ekspert kontabël dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e tij janë konsideruar atipike, si të ardhura që nuk janë përfituar nga ushtrimi i një veprimtarie ekonomike dhe, si të tilla, mund t'i nënshtroheshin vetëm tatimit mbi të ardhurat personale. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vetëm me ligjin nr. 8438, "Për tatimin mbi të ardhurat", miratuar në datën 28.12.1998, është parashikuar se të ardhura të tatueshme janë edhe "të ardhura të tjera". Ndërkohë që, në periudhën që vlerësohet, në vitin 1997, ka qenë në fuqi ligji nr. 7786, datë 27.01.1994, "Për tatimin mbi të ardhurat personale", sipas të cilit, çdo person, shqiptar a i huaj, i cili realizon të ardhura, është i detyruar të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale, të cilat mund të jenë të ardhura nga pagat apo shpërblimet për shërbime individuale, siç është edhe rasti i bashkëshortit të subjektit. Për sa më sipër, edhe nëse do të konsideroheshin pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit si ekspert kontabël, këto të ardhura nuk do të përmbushnin kriterin e të ardhurave të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të pikës 3 të Aneksit të Kushtetutës, pasi për to nuk është provuar se janë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

36.7. Trupi gjykues konstaton gjithashtu se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e të ardhurave të realizuara nga bashkëshorti gjatë vitit 1997 janë jokonsekuente. Ndërsa në deklaratën *vetting* dhe në pyetësonin standard subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhura në vlerën 360.000 lekë, në pyetësonin nr. 2, subjekti e ndryshoi këtë vlerë në 630.000 lekë. Trupi gjykues çmon se, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë akt për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave, si dhe në kushtet kur subjekti ka mospërputhje në deklaratimet e tij në deklaratën *vetting* dhe në shpjegimet e tij në Komision, atëherë pretendimet për përfitim të ardhurash, si në vlerën 360.000 lekë, ashtu edhe në vlerën 630.000 lekë, mbeten në nivel deklarativ. Edhe nëse do të pranohej se bashkëshorti i subjektit ka përfituar pagesë nga kryerja e auditimit për tri subjekte tregtare, sipas raporteve që ka paraqitur në Komision, për këto të ardhura nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore, që do të sillte legjitimitimin e tyre, sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

36.8. Në përfundim, lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se mbetet i bazuar konkluzioni i Komisionit se nuk provohet që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit të ketë kryer auditimin e 18 subjekteve apo të ketë përfituar të ardhura nga këto auditime dhe se, edhe nëse do të merrej i mirëqenë përfitimi i këtyre të ardhurave, përsëri subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë as pagesën e tatimit mbi to. Në këto kushte, të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti si ekspert kontabël për vitin 1997, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme dhe të përfshihen në analizën financiare.

37. Lidhur me pretendimet për reduktimin edhe me 40% të shpenzimeve të jetesës për periudhën deri në vitin 1999, për shkak të produkteve nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në pronësi të vjehrrit të saj, trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje

të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se familja e saj ka realizuar të ardhura nga shfrytëzimi i tokës bujqësore prej 3 dynmësh, gjatë kohës që kanë banuar në fshat dhe në Gramsh, si dhe të ardhura nga blegtoria, pemëtaria, bletaria etj., për të cilat kujdeseshin prindërit e bashkëshortit. Këta të fundit, deri në vitin 2000, bashkëjetonin me familjen e subjektit. Për këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shpenzimet për jetesë përballoheshin nga të ardhurat nga fshati. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision aktet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, nr. {***}, me nr. pasurie {***}, datë 26.02.2008, për “arë + truall”, me sipërfaqe 3.199 m², në Gramsh, Drizë, me pronar R. Ç.; (ii) vendim nr. {***}, datë 28.07.1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, ku përcaktohet se në brendësi të oborrit, gjithashtu është ndërtuar një kasolle bagëtish, e se pjesa tjetër e oborrit është mbjellë me pemë frutore e pjergulla rrushi; (iii) aktvlerësimi i llojeve drufrutore, në pronësi të familjes Ç. dhe të ardhurat prej tyre, përgatitur nga dy ekspertë të licencuar në fushën e bujqësisë.

37.1. Komisioni, në përfundim ka çmuar të konsiderojë vetëm uljen e shpenzimeve të jetesës, duke i llogaritur në 30% të të ardhurave dhe jo në masën 66% të të ardhurave familjare, që kishte konkluduar në rezultatet hetimore, duke mos marrë në konsideratë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për një reduktim tjetër prej 40% të këtyre shpenzimeve. Komisioni ka arsyetuar në vendim se, në kushtet kur nuk është provuar me dokumente shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe pagesa e taksës së tokës bujqësore, dhe subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklarata të tjera të ardhura nga toka bujqësore, si dhe nisur nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni për reduktimin i shpenzimeve të jetesës për familjet që kanë jetuar në fshat dhe/ose kanë pasur tokë në pronësi, në rastin konkret, çmoi të reduktojë shpenzimet e jetesës në masën 30% të të ardhurave familjare.

37.2. Trupi gjykues, për sa trajtuar më sipër, në përgjigje të të njëjtave pretendime të subjektit të rivlerësimit dhe në ankimin drejtuar Kolegjit, vlerëson se është e bazuar përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës nga Komisioni, në masën 30% të të ardhurave, pasi një vlerë më e ulët, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, duket se nuk e bën të besueshme se, për ato vite, mundësia e kursimit të ishte më e lartë se 70% e të ardhurave. Komisioni, përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës nuk e ka lidhur drejtpërsëdrejti me faktin se subjekti i rivlerësimit apo edhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të larta, siç referon subjekti në ankim, por si masë për përlllogaritjen e shpenzimeve, duke kryer një analizë logjike si organ rivlerësimi, referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimin nr. 15/2021 të tij.

37.3. Në përfundim, për pasurinë “banesë 2 kate në bashkëpronësi”, në Tiranë, me pjesë takuese ¼, pasi analizoi aktet në fashikull dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si dhe Komisioni, çmoi të konsiderojë si vlerë investimi shumë më prej 3.000.000 lekësh, sikurse deklaruar prej saj në mënyrë konsistente ndër vite. Pas kontrollit të analizës së Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mbulimin tërësisht me burime të ligjshme të investimit në këtë banesë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është pasojë e konstatimit që subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat e bashkëshortit si ekspert kontabël për vitin 1997 dhe të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti privat i vjehrrit gjatë viteve 1998 – 1999, të deklaruara si burim për kryerjen e investimit.

*Për pasuritë e krijuara në vitin 2007, “apartamenti me sipërfaqe 56 m²”, lagjja {***}, Plazh, Durrës, dhe “dyqani me sipërfaqe 52.32 m²”, në Tiranë*

38. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartment me sipërfaqe 56 m², lagjja {***}, Plazh, Durrës, blerë me kontratën nr. {***}, datë 24.09.2007, vërtetim dokumenti hipotekor, nr. {***}, datë 07.11.2007. Vlera: 2.000.000 lekë, pjesa takuese 50%, në bashkëpronësi me bashkëshortin. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat. Ky apartament është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2007, me të njëjtin çmim blerjeje, por pa deklaruar burimin e krijimit. Po aty, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Dyqan me sipërfaqe 52.32 m², rruga ‘{***}’. Rivlerësuar në vitin 2014; funksionon si një i tërë, i blerë sipas dokumentacionit: kontratë nr. {***}, datë 07.11.2007 dhe kontrata nr. {***}, datë 07.11.2007, certifikatë z. k. {***}, nr. pasurie {***}, dhe z. k. {***}, nr. pasurie {***}, me vlerë totale, sipas kontratave, 35.054 euro, konvertuar në vlerën 4.276.588 lekë”. Burimi i krijimit: të ardhura nga pagat dhe shitja e banesës “2+1” në Gramsh, në vitin 2003. Pjesa takuese: 50%, në bashkëpronësi me bashkëshortin. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “dyqan me sip. 52 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, blerë sipas dy kontratave, përkatësisht në vlerat 15.852 euro dhe 19.202 euro, por pa burim krijimi. Në deklaratën *vetting*, si dhe gjatë sqarimeve të dhëna gjatë procesit të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se dyqani me sipërfaqe 52.32 m² funksionon si një i tërë, pavarësisht se është blerë me dy kontrata të ndryshme.**

38.1. Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga pagat, ka kryer analizën financiare për periudhën 01.01.2007 – 07.11.2007, që përkon me pagesën e këstit të fundit të dy dyqaneve. Nga kjo analizë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e pasurive, në vlerën (-) 2.309.023 lekë. Kjo pamundësi financiare ka ardhur për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të ardhurat e ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* prej 6.150.000 lekësh, të deklaruar të krijuar në vitet 2003 – 2006, dhe që është deklaruar si burim për blerjen e këtyre pasurive, pasi subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë justifikuar me të ardhura të ligjshme likuiditetin prej 4.000.000 lekësh në fund të vitit 2003.

38.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ajo dhe familja e saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2003, në shumën 5.700.000 lekë, por ka pasur të ardhura për të krijuar shtesën gjatë vitit 2006, në shumën 450.000 lekë, e cila është e pamjaftueshme për t’u përdorur si burim për blerjen e pasurive objekt verifikimi.

38.3. Në lidhje me deklarinimin e gjendjes *cash*, për vitet 2003 – 2006 nga subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore, konstatohet se:

- a. Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar në seksionin “Likuiditete”: *shuma 4.000.000 lekë, kursime nga paga. Kursime nga të ardhurat e punës në vite dhe aktivitet privat në qytetin e Gramshit; dhe shuma 1.700.000 lekë, të ardhura nga shitja e banesës “2+1”, e privatizuar në qytetin e Gramshit. Pra, në fund të vitit 2003, gjendja cash e deklaruar rezulton të jetë 5.700.000 lekë.*

b. Në DPV-të e viteve 2004 dhe 2005, subjekti nuk ka deklaruar as shtesa dhe as pakësime të gjendjes *cash*. Në pyetësin nr. 3, subjekti ka sqaruar se deklaratën e vitit 2003 e ka ribërë me kërkesë të ILDKPKI-së në vitin 2007, për shkak se kjo deklaratë kishte humbur e nuk gjendej dhe, e pyetur nga inspektorja për kursimet e viteve 2004 dhe 2005, subjekti është shprehur se në këto vite gjendja *cash* ka qenë e njëjtë si në vitin 2003.

c. Në DPV-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash*, vlerën 450.000 lekë, si kursime nga të ardhurat për vitin 2006, e cila është shtesë e vlerës së akumuluar dhe të mbartur nga data 31.12.2005. Si rezultat, në fund të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 6.150.000 lekë.

d. Në DPV-në e vitit 2007, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të shumës 6.150.000 lekë, por në procesverbalin e datës 03.03.2009, mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se asetet e krijuara në vitin 2007 e kanë burimin e krijimit nga pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 6.150.000 lekë (*cash* i deklaruar nga vitet 2003 – 2006).

38.4. Komisioni, me qëllim evidentimin e mundësisë për krijimin me të ardhura të ligjshme të shumës 6.150.000 lekë në fund të vitit 2006, ka kryer analizën financiare, nga e cila ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi financiare për kursime për periudhën gusht 1991 – 2003, në vlerën (-) 4.357.098 lekë. Për rrjedhojë, Komisioni, duke pranuar vlerën 1.700.000 lekë nga shitja e apartamentit në Gramsh, si dhe shtesën e likuiditetit në vitin 2006, në vlerën 450.000 lekë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë justifikuar me të ardhura të ligjshme likuiditetin *cash* prej 4.000.000 lekësh, të deklaruar në fund të vitit 2003, i cili pretendohet të jetë burim për krijimin e pasurive të blera në vitin 2007.

38.5. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur të ardhura të ligjshme për të kursyer shumën 4.000.000 lekë deri në fund të vitit 2003 dhe, për pasojë, analiza financiare për mundësinë e blerjes së pasurive në vitin 2007 rezulton pozitive. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën financiare për mundësinë e krijimit të likuiditetit *cash* në fund të vitit 2003, në ndryshim nga Komisioni, duhet të merret në konsideratë se vlera e banesës dykatëshe, ndërtuar në vitet 1996 – 2000, është 1.727.494 lekë dhe jo 3.000.000 lekë, siç ka konkluduar Komisioni. Subjekti pretendon përfshirjen në analizë edhe të të ardhurave të bashkëshortit si ekspert kontabël, prej 630.000 lekësh, si dhe të ardhurat nga aktiviteti i vjehrrit, në vlerën 606.702 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon edhe reduktimin e shpenzimeve të jetesës së familjes, për shkak të pagave të larta, si dhe të të ardhurave nga toka bujqësore.

38.6. Trupi gjykues vëren se pretendimet e mësipërme janë të njëjta me shkaqet e ankimit të paraqitura për pasurinë “banesë dykatëshe”, në Tiranë, trajtuar më sipër në këtë vendim. Sipas konkluzioneve për secilin nga këto pretendime, është vlerësuar se vlera e investimit në banesën dykatëshe, në Laprakë, do të konsiderohet 3.000.000 lekë, të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i bashkëshortit si ekspert kontabël nuk do të përfshihen në analizën financiare, të ardhurat nga aktiviteti tregtar i vjehrrit do të konsiderohen në vlerën prej 393.336 lekësh, aq sa konsideruar Komisioni në analizë, ndërsa shpenzimet e jetesës llogariten në masën 30% të të ardhurave. Për rrjedhojë, analiza financiare për mundësinë e kursimeve *cash* në fund të vitit 2003 rezulton e njëjtë me atë të Komisionit, i cili ka konkluduar për një pamundësi financiare

në vlerën (-) 2.480.493 lekë, fakt që afekton rezultatin e analizës financiare të periudhës 01.01.2007 – 07.11.2007, lidhur me mundësinë e krijimit të këtyre pasurive, që rezulton me një diferencë negative prej (-) 2.309.023 lekësh. Si përfundim, trupi gjykues, duke ndarë të njëjtin qëndrim me Komisionin, konkludon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura ligjshme të mjaftueshme, që të krijonin likuiditetin *cash* të deklaruar deri në vitin 2003, prej 5.700.000 lekësh, i deklaruar si burim për blerjen e pasurive “apartament” dhe “dyqan” në vitin 2007.

38.7. Për pasuritë e krijuara në vitin 2007, Komisioni ka konstatuar se në deklaratën e pasurisë së vitit 2007, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e këtyre pasurive. Gjithashtu, në këtë deklaratë, subjekti nuk ka deklaruar as pakësim të gjendjes *cash*. Për shkak të mungesës së deklarimeve të burimit të krijimit të pasurive të blera gjatë këtij viti dhe mosdeklarimit të pakësimit të gjendjes *cash*, në kushtet kur në përfundim të procesit rezultoi që subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë justifikuar me të ardhura të ligjshme likuiditetin *cash* prej 4.000.000 lekësh në fund të vitit 2003, i cili pretendohet të jetë burim për krijimin e pasurive të blera në vitin 2007, Komisioni ka vlerësuar se këto pasaktësi marrin një peshë specifike të posaçme, të cilat e vënë subjektin në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklaratime, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

38.8. Në ankim, subjekti i rivlerësimit parashtron se mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurive dhe i pakësimit të gjendjes *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, në kundërshtim nga sa ka konkluduar Komisioni, janë pasaktësi të karakterit formal, të pashoqëruara me pamjaftueshmëri financiare dhe, si të tilla, nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore.

38.9. Trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron pretendimi se pasaktësitë në deklarin e burimeve nuk sjellin pasoja nëse nuk shoqërohen nga pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare, pasi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e këtyre pasurive, në vlerën (-) 2.309.023 lekë. Komisioni i ka dhënë peshë specifike dhe ka konsideruar si pamjaftueshmëri në deklarin, faktin që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurive në vitin 2007 në deklaratën periodike vjetore të këtij viti, por e ka lidhur këtë pamjaftueshmëri me faktin që, në përfundim të procesit, rezultoi që subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë justifikuar me të ardhura të ligjshme likuiditetin *cash*, prej 4.000.000 lekësh, në fund të vitit 2003, i cili pretendohet të jetë burim për krijimin e pasurive të blera në vitin 2007. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka korrigjuar / plotësuar pasaktësitë në deklaratën periodike vjetore, duke deklaruar në deklaratën *vetting* burimet e krijimit të pasurive “apartament” dhe “dyqane”, në rastin konkret, për këto pasuri konstatohet se pamjaftueshmëria në deklarin, sipas nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, bazohet në mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive dhe jo mbi pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike të pasurisë në vite.

38.10. Në përfundim, për pasuritë e blera në vitin 2007, “apartamentin me sipërfaqe 56 m²” në Durrës dhe “dyqanin me sipërfaqe 52.32 m²” në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur / bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar plotësisht likuiditetin në *cash* prej 5.700.000 lekësh, të deklaruar të kursyer deri në vitin 2003 dhe si burim për blerjen këtyre pasurive. Pamundësia financiare për

krijimin e kursimeve *cash* në fund të vitit 2003 afekton rezultatin e analizës financiare të periudhës 01.01.2007 – 07.11.2007, lidhur me mundësinë e blerjes së pasurive “apartament” dhe “dyqan” në vitin 2007, që rezulton me balancë negative. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së të ardhurave të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me të ardhurat nga qiratë e dyqanit me sipërfaqe 52.32 m², në Tiranë

39. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* të ardhura: nga qiratë e dyqanit, dhënë sipas kontratave nr. {***} rep., datë 23.02.2010, me afat njëvjeçar, me vlerë 20.000 lekë/muaj, dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.01.2012, afat njëvjeçar, me vlerë 20.000 lekë/muaj, në shumën 480.000 lekë; si dhe nga qiraja e dyqanit, sipas kontratës nr. {***}, datë 13.06.2016 (deklaruar edhe në DPV/2016 si më sipër), me vlerë 16.500 lekë/muaj, shuma 115.500 lekë.

39.1. Në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja e dyqanit, si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2007, të ardhura nga qiraja, sipas kontratës së datës 10.04.2007, në shumën 80.000 lekë;
- Në DPV-në e vitit 2009, ka deklaruar të ardhura nga qiraja, sipas kontratës së datës 30.01.2009, në shumën 220.000 lekë;
- në DPV-në e vitit 2010, ka deklaruar të ardhura nga qiraja, sipas kontratës së datës 30.01.2009 dhe kontratës së datës 01.02.2010, në shumën 240.000 lekë;
- Në DPV-në e vitit 2011, ka deklaruar të ardhura nga qiraja, sipas kontratës datë 01.02.2010 (2 muaj), në shumën 40.000 lekë;
- Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja mujore e dyqanit, sipas kontratës datë 13.06.2016, me vlerën 16.500 lekë/muaj.

39.2. Nga verifikimi i akteve të administruara në Komision, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës *vetting* vetëm tri kontrata qiraje, kokretisht me nr. {***} rep., datë 23.02.2010; nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.01.2012, dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.06.2016. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dy urdhërpagesa për tatimin e mbajtur në burim, nga të cilat rezulton se është paguar tatimi në burim për të ardhurat nga qiraja vetëm për disa muaj, gjatë viteve 2016 dhe 2017. Ndërkaq, në parashtrimet ndaj rezultateve të hetimit subjekti ka informuar se, pavarësisht detyrimit të qiramarrësit për të paguar tatimin, në kushtet kur nuk ka mundur të vërtetojë pagesën e tatimit, e ka kryer vetë pagesën e detyrimeve tatimore. Subjekti i rivlerësimit, bashkë më parashtrimet, ka paraqitur shkresën nr. {***} prot., datë 20.05.2022, të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve Tiranë, për pagesën e kryer për tatimin mbi qiranë, në vlerën 144.000 lekë, që i përket viteve 2009, 2010, 2012 dhe 2013.

39.3. Në përfundim, Komisioni ka çmuar të konsiderojë të ligjshme të ardhurat nga qiraja për vitet 2009, 2010, 2012 dhe 2016, tatimi mbi të cilat është paguar nga subjekti, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë: (i) subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja edhe në deklaratat

vjetore, edhe në deklaratën *vetting*; (ii) subjekti ka provuar marrëdhënien e qirasë me personat fizikë, duke paraqitur kontratat e qirasë për këto vite, në të cilat parashikohet vlera e qirasë dhe përcaktohet se detyrimi për pagesën e tatimit i takon qiramarrësit; (iii) qiramarrësit, si palë në kontratat e paraqitura nga subjekti, janë persona fizikë dhe, si të tillë, kanë detyrimin ligjor për pagesën e tatimit mbi qiranë; (iv) subjekti i ka paguar vetë detyrimet tatimore, pasi ka marrë dijeni se qiramarrësit, pavarësisht se e kanë pasur detyrim, nuk kishin paguar tatimin në burim.

39.4. Ndërkohë, Komisioni nuk ka konsideruar të ardhurat nga qiratë për vitin 2007, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë kontratë qiraje për këtë vit, pavarësisht se në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar të ardhura nga qiraja e dyqanit, në vlerën 80.000 lekë. Edhe për vitin 2013, Komisioni nuk ka konsideruar të ardhura nga qiraja, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kontratë qiraje për këtë vit, pavarësisht se ka paguar tatimin në burim.

39.5. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit që nuk ka njohur të ardhurat nga qiraja për vitin 2013, pasi njësia e shërbimit në vitin 2012 i është dhënë me qira subjektit tregtar / farmaci “{***}”, që ka vazhduar të njëjtin aktivitet edhe për vitin 2013. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, në kushtet kur ka paguar tatimin mbi këto të ardhura, ato duhet të ishin përfshirë në analizën financiare nga Komisioni, në vlerën që janë deklaruar.

39.6. Referuar pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se ajo ka paraqitur kontratën noteriale të qirasë, datë 06.01.2012, të lidhur me subjektin tregtar “{***}”. Sipas kësaj kontrate, afati i lidhjes së saj është njëvjeçar, nga data 05.01.2012 deri në datën 05.01.2013. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë lidhur një kontratë tjetër me këtë subjekt, pas përfundimit të kontratës nr. {***}, datë 06.01.2012, ndërkohë që në këtë kontratë, palët kanë rënë dakord që *ndryshimet dhe shtesat në këtë kontratë do të jenë të vlefshme, vetëm në rast se janë me shkrim dhe të firmosura nga të dyja palët.*

39.7. Trupi gjykues vëren se, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë vazhdimin e marrëdhënies së qirasë dhe përfitimin e të ardhurave nga kjo qira edhe për vitin 2013, vetëm pagesa e tatimit në burim për të ardhurat nga qiraja nuk mund të provojë ekzistencën e tyre. Kolegji, në vendimin 15/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita, ka arsyetuar se: *Në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet, duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit, duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur, në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit, për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie, apo një qëllim për t'u arritur.*

39.8. Bazuar në të dhënat e akteve, si dhe në qëndrimin e mësipërm të Kolegjit, trupi gjykues konkludon se pagesa me vonesë e detyrimeve tatimore nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurat nga qiraja nuk ka efekt në drejtim të provueshmërisë së këtyre të ardhurave dhe është i bazuar qëndrimi i Komisionit, që nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për vitin 2013, në vlerën 240.000 lekë.

39.9. Në përfundim, për të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë “dyqan me sipërfaqe 52.32 m²”, në Tiranë, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin dhe çmon të konsiderojë të ligjshme të ardhurat vetëm për vitet 2009, 2010, 2012 dhe 2016, duke mos pranuar pretendimin për të njohur të ardhurat nga qiraja edhe për vitin 2013, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me akte marrëdhënien e qiradhënies për këtë vit.

Për gjendjen cash në fund të vitit 2010 dhe deri në datën 03.03.2011

40. Subjekti i rivlerësimit në ankim, lidhur me analizën financiare të vitit 2010, parashton se gjendja e likuiditetit *cash* në fund të vitit 2010 dhe në momentin e largimit nga detyra në datën 03.03.2011, duhej të llogaritej në vlerën 1.500.000 lekë dhe jo në vlerën 2.200.000 lekë që ka konsideruar Komisioni, pasi saktësimi për këtë gjendje likuiditeti është bërë në deklaratën e pasurisë të vitit 2016.

40.1. Në shqyrtim të këtij shkakui ankimi, nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, trupi gjykues konstaton se:

– Në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar: *Kursime nga të ardhurat për vitin 2007, shuma cash 300.000 lekë*⁷.

– Në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura cash nga kursimet e pagës të vitit 2008, 500.000 lekë*. Në fund të vitit 2008, gjendja *cash* rezulton në vlerën 800.000 lekë.

– Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *Kursime cash nga të ardhurat e pagave dhe qirasë për vitin 2009, 700.000 lekë*. Në fund të vitit 2009, gjendja *cash* është në vlerën 1.500.000 lekë.

– Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *Kursime cash nga të ardhurat e pagave dhe qirasë për vitin 2010, 700.000 lekë*. Sipas Komisionit, në fund të vitit 2010, gjendja *cash* është në vlerën 2.200.000 lekë.

– Në deklaratën pas largimit nga funksioni, të datës 03.03.2011, dorëzuar në datën 29.03.2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar mbi gjendjen *cash*.

– Në deklaratën para fillimit të detyrës, të datës 18.11.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Gjendje cash (nga kursimet ndër vite, qira e dyqanit) 900.000 lekë*.

– Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *Gjendja cash, pakësuar nga 1.500.000 lekë, mbetet në shumën 900.000 lekë*.

⁷ Në DPV-në e vitit 2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursime nga të ardhurat për vitin 2007, shuma cash 3.000.000 lekë, ndërsa në procesverbalin me ILDKPKI-në, të datës 03.03.2009, ka saktësuar se vlera e cash-it ka qenë 300.000 lekë. Në fund të vitit 2007, gjendja cash ka qenë 300.000 lekë, duke konsideruar se shuma 6.150.000 lekë, e deklaruar në vitin paraardhës, është përdorur për blerjen e tri pasurive në vitin 2007.*

– Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Gjendje cash 900.000 lekë. Burimi: kursime.*

40.2. Nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, rezulton se në procesverbalin e datës 07.02.2017, që ILDKPKI-ja i ka dërguar Komisionit në datën 28.04.2020, subjekti dhe bashkëshorti i saj (të dy subjekte deklaruese) kanë dhënë sqarime lidhur me burimin e krijimit të likuiditeteve *cash* të deklaruara në DPV-në 2003, gjendjen e likuiditetit *cash* në vitin 2007, prej 300.000 lekësh, dhe kanë deklaruar se gjendja e likuiditetit *cash*, në datën 31.12.2015, ishte 1.500.000 lekë, shumë e cila është përdorur në vitin 2016.

40.3. Në pyetësin nr. 3, në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në vitin 2010 është bërë blerja e dy makinave dhe një udhëtim në Turqi, duke shpenzuar nga gjendja *cash* e akumuluar më parë, shumën 700.000 lekë. Sipas subjektit, gjendja *cash*, në fund të vitit 2010, ka mbetur në shumën 1.500.000 lekë. Subjekti pretendon se gjendja *cash*, në datën 31.12.2010 dhe deri më datë 03.03.2011, momenti i largimit nga detyra i subjektit si ndihmëse ligjore, duhet të llogaritet në vlerën 1.500.000 lekë dhe jo në vlerën 2.200.000 lekë, që ka konsideruar Komisioni, pasi saktësimi është bërë në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2016. Ky konsiderim i gjendjes së likuiditetit *cash*, prej 1.500.000 lekësh, sipas pretendimit të subjektit, do të rezultonte me ndryshim të diferencës negative për analizën e vitit 2010, duke e ulur këtë diferencë me 700.000 lekë. Komisioni, në rezultatet hetimore, ka konkluduar për analizën financiare të vitit 2010 me diferencë negative prej (-) 1.211.116 lekë dhe, në përfundim, pasi ka marrë në konsideratë të ardhurat nga qiratë e njësisë “dyqan”, ka konkluduar për një diferencë negative më të vogël prej (-) 1.001.116 lekësh.

40.4. Nga të dhënat nga aktet, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës si inspektore në KLD, të datës 18.11.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Autoveturë “Renault”, blerë më 06.11.2010, në shumën 270.000 lekë. Burimi: Kursime nga pagat.* Ndërkaq, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e dy automjeteve, përkatësisht në vlerat 270.000 lekë dhe 630.000 lekë. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e largimit nga detyra si ndihmëse ligjore më datë 03.03.2011, ndërsa deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, në datën 29.03.2011. Për periudhën 31.12.2010 – 03.03.2011, nuk rezulton asnjë krijim pasurie nga subjekti dhe personi i lidhur, fakt që prezumon se gjendja *cash*, në fund të vitit 2010 dhe në datën 03.03.2011, të ketë qenë e njëjtë. Po sipas akteve dhe analizës në Komision për periudhën kur subjekti nuk ka qenë në detyrë, 03.03.2011 – 18.11.2016, nuk është evidentuar krijim pasurish nga ajo dhe familjarët e saj.

40.5. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka deklaruar në procesverbalin e datës 07.02.2017 të ILDKPKI-së, se gjendja e likuiditetit *cash*, në datën 31.12.2015, ishte 1.500.000 lekë, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se deklarimet e kryera përgjatë proceseve verifikuese në ILDKPKI janë konsideruar si elemente ndihmëse në sqarimin dhe saktësimin e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike, kur ato kanë qenë të paqarta apo të paplota, por në asnjë rast ato nuk janë konsideruar si deklarime origjinare të kryera prej subjekteve. Për këto arsye, pretendimi i subjektit për të konsideruar si deklarime të gjendjes *cash* shpjegimet e dhëna gjatë pyetjes në ILDKPKI në vitin 2017, kur kishte filluar procesi i rivlerësimit, u konsiderua i pambështetur në ligj.

40.6. Në përmbledhje të të dhënave të mësipërme për gjendjen cash të krijuar në fund të vitit 2010 dhe deri në datën 03.03.2011, pas verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit për vlerën provuese të deklaratave të pasurisë në procesin e rivlerësimit, sipas parashikimit të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim si Komisioni, konkretisht se gjendja cash e deklaruar në fund të vitit 2010 është në vlerën 2.200.000 lekë.

Për automjetin tip “Renault”, blerë më datë 06.11.2010

41. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë *autoveturë “Reno”*, blerë me kontratën nr. {***}, datë 06.11.2010, në shumën 270.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga pagat. Pjesa takuese: 100%. Blerja e këtij automjeti është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në DPV-në e vitit 2010 me të njëjtin çmim, por pa deklaruar burimin e krijimit. Në lidhje me këtë automjet, nga aktet në dosje konstatohet se me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 06.11.2010, znj. Brunilda Çarçiu ka blerë nga shtetasi A. B. automjetin tip “Renault Clio”, në çmimin 270.000 lekë, për të cilin palët deklarojnë se janë likuiduar dhe nuk ka pretendime për gjendjen teknike të automjetit.

41.1. Komisioni ka kryer analizën financiare për të evidentuar mundësinë e subjektit për blerjen e automjetit në datën 06.11.2010, analizë që ka filluar pas datës 29.05.2010, për të shmangur mbivendosjen e rezultateve, pasi nga bashkëshorti i subjektit, më 29.05.2010, është blerë automjeti tjetër “Mercedes-Benz” (analizuar në vijim). Pasi analizoi pretendimet e subjektit në lidhje me analizën financiare për blerjen e automjetit dhe pasi konsideroi përfshirjen e të ardhurave nga qiraja për periudhën e analizuar, në përfundim të procesit, Komisioni ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme, në vlerën (-) 334.170 lekë.

41.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamundësinë financiare në vlerën (-) 334.170 lekësh për blerjen e automjetit nga bashkëshorti, duke pretenduar se analiza financiare për të konstatuar mundësinë e blerjes më datë 06.11.2010 rezulton pozitive. Sipas subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare për mundësinë e blerjes së automjetit duhet të përfshihen: (i) të ardhurat nga qiraja për vitet 2009 dhe 2010, në vlerën 220.000 lekë; (ii) të ardhurat nga shitja e automjetit, tip “Mercedes-Benz”, në datën 30.06.2010, në vlerën 400.000 lekë; dhe (iii) shuma 2.057 USD, e sjellë nga z. K. R., në llogarinë e bashkëshortit në Raiffeisen Bank.

41.3. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore dhe i deklaratës *vetting*, trupi gjykues, së pari, konstaton se subjekti deklaroi si burime për blerjen e automjetit të ardhurat nga qiraja dhe dhurimin nga familja R., vetëm pas fillimit të hetimit administrativ në Komision, ndërkohë që në deklaratën *vetting* kishte deklaruar si burim kursimet nga paga.

41.4. Për sa u përket të ardhurave nga qiraja për vitin 2010, trupi gjykues vëren se Komisioni ka konsideruar të ligjshme dhe ka marrë në konsideratë të ardhurat nga dhënia me qira e dyqanit për këto vite, ashtu si dhe është parashtruar më sipër në këtë vendim. Por, subjekti i rivlerësimit në ankim kërkon që për vitin 2010 të konsiderohet qiraja për 11 muaj, për periudhën janar – nëntor (20.000 lekë / muaj për 11 muaj, shuma prej 220.000 lekësh), ndërkohë që Komisioni, me të drejtë ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga qiraja për 6 muaj, për periudhën

qershor – nëntor 2010, në vlerën prej 120.000 lekësh, pasi kjo është periudha për të cilën bëhet analiza financiare për mundësinë e blerjes së automjetit. Komisioni ka kryer analizën financiare për blerjen e këtij automjeti për periudhën qershor – nëntor 2010, me qëllim për të shmangur mbivendosjen e rezultateve, pasi në datën 29.05.2010, subjekti i rivlerësimit ka blerë një tjetër automjet, tip “Mercedes-Benz”, i cili është analizuar më vete. Për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideron jo të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për periudhën për të cilën është llogaritur vlera e qirasë, që duhet të përfshihet në analizën financiare.

41.5. Për sa i përket pretendimit për përfshirjen në analizën financiare të shumës 2.000 USD, dhënë si dhuratë nga z. K. R., banues në ShBA, nga aktet në fashikuj rezulton se në përgjigjen e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë nga kunati dhe nipi (familja R. në ShBA) me transfertë bankare, shumën 2.057 USD, pasi bashkëshorti, me prokurë të posaçme të lëshuar prej tyre, ka qenë i autorizuar për të kryer veprimet për blerjen e apartamentit në Tiranë, si dhe ka marrë një shumë 7.000 USD *cash*, pas dasmës së z. D. R., në qershor të vitit 2012.

41.6. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi mënyrën e dhënies së shumave të mësipërme, duke i dokumentuar këto veprime, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka informuar se shuma 9.000 USD është dhënë nga familja Robo, nga e cila 2.000 USD me transfertë bankare, në vitin 2010, mbetur nga blerja e banesës së porositur nga familja R. dhe 7.000 USD *cash*, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për organizimin e dasmës së djalit në vitin 2012, deklaruar edhe nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 1. Sipas subjektit të rivlerësimit, shtetasi amerikan D. R. ka qenë dhe vijon të jetë në marrëdhënie pune. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të datës 05.02.2017, të këtij personi, i cili deklaron se, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje, për organizimin e dasmës së tij në vitin 2012, i ka dhuruar dajës së tij, A. Ç., shumën 9.000 USD. Nga kjo shumë, 2.000 USD janë dorëzuar me anën e një transferte bankare në vitin 2010, si dhe 7.000 USD janë dorëzuar *cash*.

41.7. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit në Raiffeisen Bank, është evidentuar se janë kryer këto veprime: (i) në datën 20.10.2010, ka ardhur me transfertë shuma 1.958 USD, nga llogaria e shtetasve K. dhe D. R., duke bërë që balanca e llogarisë në këtë datë të jetë në vlerën 2.057,45 USD; (ii) në datën 13.02.2013, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank shumën 8.000 USD, me përshkrimin: *A. Ç. derdh në llogari*. Shuma 8.000 USD, sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, rrjedh prej dhuratës 7.000 USD nga shtetasi D. R. dhe 1.000 USD nga babai i bashkëshortit.

41.8. Për të provuar të ardhurat e shtetasit D. R., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një dokument zyrtar të të ardhurave personale nga punësimi i këtij shtetasi për vitin 2012, i përkthyer nga gjuha angleze dhe noterizuar më datë 02.06.2022, sipas të cilit, ai, për vitin 2012, ka realizuar të ardhura në vlerën 97.367,44 USD. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka provuar me dokumentacion të ardhurat nga z. D. R., nga të cilat duket se z. R. ka pasur mundësi financiare për të dhuruar shumën 7.000 USD në vitin 2012. Për këtë arsye, kjo shumë është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të rishikuar të këtij viti. Ndërsa, për shumën 2.057 USD, Komisioni ka konkluduar se nuk u provuan me dokumentacion të ardhurat

e ligjshme që kanë shërbyer si burim për shumat e dhuruara në favor të bashkëshortit të subjektit nga familja R., dhe se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi të krijojnë me të ardhura të tyre të ligjshme shumën 2.057 USD, të transferuar në llogarinë e bashkëshortit në tetor të vitit 2010.

41.9. Nga verifikimi i akteve, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka sjellë në Komision asnjë dokumentacion për të provuar të ardhurat e shtetasve D. R. dhe K. R. për vitin 2010. I vetmi akt i paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision nga subjekti i rivlerësimit ka qenë një deklaratë e datës 05.02.2017, e shtetasit D. R., në të cilën ai ka deklaruar se i ka dhuruar dajës së tij, A. Ç., shumën 9.000 USD, nga e cila 2.000 USD janë dorëzuar me anën e një transferte bankare, si dhe 7.000 USD janë dorëzuar *cash*. Trupi gjykues vlerëson se, në kushtet e mungesës së një dokumenti zyrtar që të provojë të ardhurat e këtyre shtetasve dhe të mosdeklarimit të dhurimit nga subjekti i rivlerësimit, si në deklaratat periodike vjetore, ashtu dhe në deklaratën *vetting*, është i bazuar qëndrimi i Komisionit, që nuk ka përfshirë në analizën financiare si të ardhur e ligjshme, shumën 2.057 USD (apo 1.958 USD, provuar si të kaluar në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank), të depozituar në llogarinë e bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”.

41.10. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme për të ardhurat nga qiraja për vitin 2010, si dhe për shumën 2.057 USD, të pretenduar të dhënë nga shtetasit D. R. dhe K. R., konkludohet ashtu si edhe Komisioni, se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi për blerjen e automjetit “Renault”, pasi nga kontrolli i analizës financiare në Kolegj, për periudhën 29.05.2010 – 06.11.2010, rezultojnë në mungesë të burimeve të ligjshme, në masën prej (-) 377.325 lekësh. Diferenca më e madhe se Komisioni, prej 43.155 lekësh, vjen si kombinim i më pak të ardhurave, prej 64.942 lekësh⁸, si dhe nga ndryshimi i shtesës së likuiditeteve, më pak se Komisioni, prej 21.787 lekësh⁹.

41.11. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare për blerjen e automjetit në datën 06.11.2010, të të ardhurave prej 400.000 lekësh nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz”, në datën 30.06.2010, trupi gjykues vëren se Komisioni ka konsideruar se kjo e ardhur është marrë përpara lidhjes së kontratës së datës 06.11.2010 dhe ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tjetër “Mercedes-Benz”, në datën 29.05.2010. Komisioni, të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit në datën 30.06.2010, i ka konsideruar në analizën financiare të kryer deri në datën 29.05.2010 (shkaku trajtuar në vijim në këtë vendim), si burim për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, në këtë datë, konkluzion që vlerësohet i bazuar edhe nga trupi gjykues.

⁸ Për të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortit, Komisioni dhe subjekti kanë konsideruar nga paga vjetore atë përpjesëtimore për muajt qershor – nëntor 2010, ndërsa sipas akteve në fashikujt e Komisionit, rezultojnë më pak të ardhura (prej 64.942 lekësh), sipas kalimeve në llogarinë e pagës të subjektit në Credins Bank, prej 545.794 lekësh, dhe të bashkëshortit në BKT Bank, prej 94.256 lekësh.

⁹ Për ndryshime / shtesa të likuiditeteve, Komisioni dhe subjekti i rivlerësimit kanë konsideruar shtesë prej 310.784 lekësh, ndërsa sipas akteve në fashikujt e Komisionit, rezultojnë 288.997 lekë (21.787 lekë më pak), pasi Komisioni dhe subjekti duket se nuk ka konsideruar balancë në USD, ndërkohë që, më datë 29.05.2010, balanca ka qenë 99.45 USD dhe është shtuar në datën 06.11.2010 me 1.958 USD, e konvertuar diferencë, pra shtesa, me kursin e vitit 2010.

41.12. Për rrjedhojë, për pasurinë “automjet”, tip “Renault”, blerë më datë 06.11.2010, në vlerësimin e trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë dhurimin e shumës 2.057 USD nga të afërmit e tij, të deklaruar si një nga burimet për krijimin e kësaj pasurie, dhe as të ardhurat e ligjshme të tyre për dhurimin e kësaj shume, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016, për këtë pasuri.

Për automjetin tip “Mercedes-Benz”, blerë më datë 29.05.2010

42. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *Automjet tip “Mercedes-Benz”, kontratë shitblerje nr. {***}, datë 29.5.2010. Vlera: 630.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat dhe shitja e “Benz-it 190” të mëparshëm, në shumën 400.000 lekë”.*

42.1. Për blerjen e këtij automjeti Komisioni ka evidentuar një balancë negative prej (-) 53.357 lekësh, të cilën e ka vlerësuar të pakonsiderueshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se edhe kjo balancë negative, në fakt, nga analiza financiare rezulton të jetë pozitive, për shkak të vlerës së shitjes së automjetit në vitin 2010, sipas kontratës së shitjes në shumën 400.000 lekë dhe jo 250.000 lekë (vlera e blerjes së tij në vitin 2005).

42.2. Komisioni ka konstatuar se automjeti tip “Mercedes-Benz 190”, me targa {***}, është blerë nga bashkëshorti i subjektit, sipas kontratës së blerjes nr. 5094/523, datë 02.06.2005, në vlerën 250.000 lekë. I pyetur mbi arsyet e shitjes së këtij automjeti pas pesë vjetësh, në një vlerë më të lartë (400.000 lekë) sesa çmimi i blerjes 250.000 lekë, subjekti ka sqaruar se nuk ka ndonjë arsye specifike, përveç faktit që blerësi donte ta blinte këtë lloj automjeti “Mercedes-Benz”, i cili ishte i mirëmbajtur dhe në gjendje shumë të mirë teknike, dhe se i hynte në punë në veprimtarinë e tij. Komisioni, në kushtet kur ky pretendim ka qenë në kuadër deklarativ dhe nuk justifikohet shitja e automjetit në vlerën 400.000 lekë (rreth dyfishin e çmimit të blerjes, pas pesë vitesh nga data e blerjes) në vitin 2010, në analizën financiare të automjetit objekt shqyrtimi, ka konsideruar si të ardhur të ligjshme nga shitja, vlerën 250.000 lekë.

42.3. Trupi gjykues konstaton se, sipas analizës financiare të Komisionit në rezultatet hetimore për periudhën 01.01 – 29.05.2010, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në datën 29.05.2010, pavarësisht një balance negative prej (-) 53.357 lekësh, e cila është vlerësuar e pakonsiderueshme nga Komisioni. Në vendim Komisioni ka konkluduar se: *nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi për blerjen e automjetit më 29.05.2010, pavarësisht një balance negative prej 53.357 lekësh, është vlerësuar e pakonsiderueshme. Me rishikimin e analizës financiare, në përfundim të procesit, duke përfshirë në këtë analizë të ardhurat nga qiraja për periudhën e analizuar, kjo balancë bëhet nga negative në pozitive. Pra, diferenca negative e konstatuar nga Komisioni lidhur me blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, në datën 29.05.2010, nuk ka dhënë asnjë pasojë dhe, në këto kushte, ankimi i subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim nuk gjendet i bazuar.*

43. Subjekti i rivlerësimit, në vijim të parashtrimeve të paraqitura në ankim për pasuritë, ka kërkuar nga Kolegji që të marrë në konsideratë në analizën financiare përfundimtare: (i) *investimin për ndërtimin e pjesës takuese të banesës dykatëshe, në vlerën 1.727.494 lekë; (ii) përfshirjen e të ardhurave të vjehrrit nga aktiviteti privat në fshatin Drizë, Gramsh, në vlerën 606.702 lekë; (iii) përfshirjen e të ardhurave të bashkëshortit si ekspert kontabël në vitin 2007; (iv) reduktimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1991 – 1999, për shkak të ekonomisë bujqësore dhe blegtorale; (v) përfshirjen e të ardhurave nga qiraja e njësisë për vitin 2013; (vi) përfshirjen si të ardhur të ligjshme, të shumës 2.057,45 USD, dhënë si dhuratë nga kunati dhe nipi i bashkëshortit, transferuar në llogarinë e tij më datë 20.10.2010; (vii) shumën 1.000 USD, të dhuruar nga babai i bashkëshortit në vitin 2013; (viii) vlerën e shitjes së automjetit në vitin 2010, sipas kontratës së shitblerjes, në shumën 400.000 lekë, dhe jo në vlerën 250.000 lekë, siç ka konkluduar Komisioni; (ix) gjendjen cash në fund të vitit 2010, në vlerën 1.500.000 lekë.*

43.1. Në përfundim të procesit, Komisioni, pasi ka rishikuar analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, në përfundim ka konkluduar se balanca negative ndryshon nga (-) 9.222.340 lekë në (-) 4.824.260 lekë. Kjo balancë negative është totali i pamundësisë së subjektit për të krijuar pasuritë, likuiditetet dhe për të mbuluar shpenzimet për periudhat si vijon:

i) 03.03.2011 – 18.11.2016, kur subjekti i rivlerësimit nuk është në detyrë, periudhë e cila, në përfundim të procesit, ka rezultuar me një balancë negative prej (-) 1.155.914 lekësh. Kjo balancë është mbartur / reflektuar në analizën financiare të të gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak se pasuritë dhe likuiditetet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë deklaruar në deklaratën *vetting*;

ii) 01.08.1991 – 03.03.2011 dhe 18.11.2016 – 31.12.2016, kur subjekti është në detyrë, e cila, në përfundim të procesit, ka rezultuar me një balancë negative prej (-) 3.668.345 lekësh¹⁰.

43.2. Pasi kontrolloi analizën financiare të kryer në Komision, në konsideratë të konkluzioneve të dhëna për shkaqet e ankimit për çdo pasuri, si më sipër në këtë vendim, si dhe duke përfshirë edhe të ardhurat nga bursa e shkollës së vajzës në vitet 2008, 2009,¹¹ trupi gjykues konkludon se, për periudhën gjatë ushtrimit të detyrës deri në datën 03.03.2011, dhe për periudhën 18.11.2016 – 31.12.2016, pas disa ndryshimeve në Kolegji të disa prej elementeve të analizës

¹⁰ Si total i diferencave negative: i) deri në vitin 2003, prej (-) 2.480.493 lekësh; ii) për vitin 2008, prej (-) 57.009 lekësh; iii) për vitin 2009, prej (-) 109.152 lekësh; iv) për vitin 2010, prej (-) 1.001.116 lekësh; dhe, v) për periudhën 18.11.2016 – 31.12.2016, prej (-) 1.176.489 lekësh.

¹¹ Kolegji nuk pranoi përfshirjen në analizë të shumës 1.000 USD, të pretenduar si të dhuruar nga babai i bashkëshortit në vitin 2012, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor dhurimin e kësaj shume, të cilën nuk e ka deklaruar as në deklaratën *vetting*.

financiare të Komisionit¹², rezulton një balancë negative prej (-) 3.581.006 lekësh¹³ (87.339 lekë më pak se Komisioni), ndërsa për periudhën kur subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë, rezulton një diferencë prej (-) 1.625.800 lekësh¹⁴.

43.3. Ashtu si dhe qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, sa i takon balancës negative në periudhën jashtë detyrës, referuar standardit të mbajtur në raste të ngjashme edhe nga Kolegji, nisur nga rrethanat faktike të kësaj balance, si dhe vlera e saj, trupi gjykues çmon se, proporcionalisht, kjo balancë negative nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit. Kjo edhe në konsideratë të faktit se, ndonëse disa pasuri në formë likuiditetesh të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit, në këtë periudhë dhe të mbartura deri në deklaratën *vetting*, janë të pajustificuara me burime të ligjshme, këto likuiditete nuk u vërtetua të jenë investuar për krijimin e ndonjë pasurie gjatë periudhës së detyrës.

43.4. Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhat në analizë, deri në datën 03.03.2011 dhe 18.11.2016 - 31.12.2016, që përbëjnë periudhat kohore gjatë të cilave ajo ka qenë edhe subjekt deklarues. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 84/2016.

44. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve në pikat 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 542, datë 20.06.2022, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

¹² Diferencat me rezultatet e viteve për periudhën gjatë ushtrimit të detyrës në Komision vijnë nga viti 2008, 2009, 2010 dhe periudha 18.11.2016 – 31.12.2016, pasi në analizën e Komisionit duhej: i) të përfshiheshin të ardhurat nga bursa e shkollës së vajzës, 30.000 lekë në vitin 2008 dhe 24.000 lekë në vitin 2009, kaluar në Credins Bank; ii) saktësimi i të ardhurave nga qiraja në vitin 2010, në vlerën prej 220.000 lekësh (10.000 lekë më shumë se Komisioni), dhe të ardhurave nga paga e vajzës së subjektit, Andja Çarçiu, në periudhën 18.11.2016 – 31.12.2016, në total vlera 121.720 lekë (60.860 lekë më shumë se sa konsideruar Komisioni); iii) diferenca në balancën e gjendjes së llogarive, lidhur me kursin e këmbimit të valutës, pasi Komisioni, ekuivalentet në lekë të gjendjes së llogarive në USD e euro i ka konsideruar total balance me kursin e vitit, ndërkohe ndryshimet e kursit të këmbimit kanë dhënë efekt për shtesë likuiditeti më shumë, ndërsa në Kolegj është konsideruar praktika që vetëm shtesa e likuiditetit gjatë vitit është konvertuar me kursin e vitit; iv) balanca të paevidentuara në analizë, pasi në analizën e periudhës 18.11.2016 – 31.12.2016, Komisioni nuk ka konsideruar balancë në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në Raiffeisen Bank, në llogarinë në euro, ndërkohë sipas lëvizjeve të llogarive, rezulton se më 18.11.2016 ka pasur gjendje vlerën 501 euro, të cilën e ka tërhequr më pas më 25.11.2016.

¹³ Si total i diferencave negative: i) deri në vitin 2003, prej (-) 2.480.493 lekësh; ii) për vitin 2008, prej (-) 27.009 lekësh; iii) për vitin 2009, prej (-) 85.291 lekësh; iv) për vitin 2010, prej (-) 988.212 lekësh.

¹⁴ 469.886 lekë më shumë në krahasim me Komisionin, pasi janë konsideruar: i) 16.051 lekë të ardhura më pak se Komisioni, për shkak të të ardhurave nga paga, sipas lëvizjeve në llogaritë bankare, si dhe të përfshirjes në analizë të interesave bankare nga bonot e thesarit; ii) 685.896 lekë shpenzime më shumë se Komisioni, pas korrigjimit të shpenzimeve për vitin 2016, llogaritur në Kolegj për 10 muaj dhe 18 ditë, në ndryshim nga Komisioni, që i ka llogaritur për 43 ditë; iii) 232.062 lekë, pasuri likuiditete më pak se Komisioni, siç është shpjeguar në poshtëshënimin nr. 12, më sipër, në nëndarjet “iii” dhe “iv”.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 542, datë 20.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 12.02.2026, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi – kundër

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores së çështjes, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit nr. 16, datë 12.02.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji), që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu.
2. Lidhur me çështjen e trajtimit ligjor të statusit të ankueses, nëse është subjekt rivlerësimi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, kam ndarë të njëjtin qëndrim me analizën dhe interpretimin që shumica e trupit gjykues ka bërë në vendim, se ankuesja, sipas përcaktimit kushtetues, gëzon cilësinë e subjektit të rivlerësimit dhe duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar.
3. Si relatore, kam propozuar që vendimi nr. 542, datë 20.06.2022, i Komisionit, që ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duhet të ndryshohet, duke u konfirmuar subjekti edhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Arsyetimin mbi të cilin e kam bazuar qëndrimin tim, e paraqes si më poshtë.
4. *Për pasurinë “banesë private 2 kate”, në bashkëpronësi, në Laprakë, Tiranë, ndërtuar deri në vitin 2000*, kam vlerësuar se shumica e trupit gjykues duhej të pranonte pjesërisht kërkesën e subjektit për të konsideruar vlerën e banesës 2-katëshe, sipas kostos mesatare të ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB), meqenëse nuk ka pasur akte provuese të kohës. I qëndroj këtij mendimi, meqenëse Kolegji, në raste të tjera¹⁵, ka pranuar të bëjë këtë përllogaritje, edhe pse vetë subjekti ka deklaruar vlerën prej 3 milionë lekësh si kosto e ndërtimit të banesës, edhe në deklaratën *vetting*, edhe gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision. Në vlerësimin tim, shumica duhej të pranonte kërkesën e subjektit, sepse evidentohet qartazi që: i) vlera e dhënë prej saj është një vlerë subjektive, e përafërt, pa u bazuar në çmimet e EKB-së; ii) nuk ka dokumentacion mbështetës tekniko-ligjor; iii) është ndërtim informal, me cilësi të ulët, ndërtuar për një periudhë të gjatë kohore; iv) nuk ekzistonte ligji për deklarimin e pasurisë dhe, pa dashje, subjekti ka penalizuar veten, duke deklaruar një vlerë më të lartë. Gjithashtu, në deklaratën *vetting*, vetë subjekti ka specifikuar: *e vlerësuar sipas çmimeve të kohës*. Në këto kushte, me qëllim mospërkeqësimin e situatës financiare të subjektit, kam vlerësuar që, të paktën vlera e banesës të llogaritet në shumën prej 2.249.938 lekësh, sipas përllogaritjes në Kolegj.
5. Në mënyrë të detajuar, kam vlerësuar rishikimin e vlerës, sipas përllogaritjes me kosto ndërtimi për vitet 1997 – 2000, sipas shkresave që EKB-ja i ka dërguar Kolegjit për komponentët e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave¹⁶, ku *fitimi i planifikuar dhe fondi rezervë* për vitet nga 1997 në 2000 është në masën e 8.83%¹⁷. Aplikimi i kësaj uljeje për koston e ndërtimit në periudhën 1997 – 2000 do të sillte një kosto totale ndërtimi prej

¹⁵ *Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nr. 6/2022 (JR), datë 17.03.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit H. K.*

¹⁶ *Shkresat e EKB-së drejtuar Kolegjit, nr. {***} prot., datë 11.03.2019; EKB, drejtuar Kolegjit, nr. {***} prot., datë 13.10.2021; EKB drejtuar Kolegjit, nr. {***} prot., datë 21.10.2021.*

¹⁷ *Si total i fondit rezerve prej 3.97% dhe pjesa e fitimit të planifikuar, si pjesë e shpenzimeve të përgjithshme dhe fitim i planifikuar.*

2.249.938 lekësh, më e vogël se vlera e deklaruar nga subjekti dhe e konsideruar nga Komisioni në analizë, prej 3.000.000 lekësh (-750.062 lekë). Për sa më lart, analiza për krijimin e kësaj pasurie deri në fund të vitit 2000, ku Komisioni, dhe më pas, shumica në vendimin e Kolegjit, ka konfirmuar të njëjtin konkluzion, ka rezultuar me diferencë negative prej (-) 206.928 lekësh, *do të ndryshonte rezultatin, nga me diferencë negative, në diferencë pozitive.*

6. Përpos pretendimit të subjektit për koston e ndërtimit të banesës, referuar analizës financiare të periudhës deri në fund vitit 2000, ajo ka pretenduar edhe: a) të ardhura nga bashkëshorti prej 630.000 lekësh (shumica në vendim dhe Komisioni nuk i kanë konsideruar këto të ardhura); b) të ardhura nga aktiviteti i vjehrrit prej 606.702 lekësh (më shumë se shumica dhe Komisioni, prej 213.366 lekësh); d) shpenzime jetese 958.634 lekë (më pak se KPK-ja, prej 557.396 lekësh). Në ndryshim nga analiza e shumicës së trupit gjykues në vendim, si dhe nga vendimi i Komisionit, kam vlerësuar të drejtë pretendimin e subjektit në ankim për të konsideruar sa më poshtë:

6.1. Të ardhurat nga aktiviteti i vjehrrit, ashtu si pretenduar nga subjekti, prej 606.702 lekësh, pra, në ndryshim nga Komisioni edhe për vitet 1998 – 1999 (me shumë se Komisioni prej + 213.366 lekësh). Vlerësoj se trazirat e vitit 1997 i kanë shtrirë efektet e pamundësisë për të disponuar akte dhe vërtetuar të ardhurat e krijuara, edhe për vitet 1998 – 1999, mbështetur edhe në aktet e sjella nga subjekti bashkëlidhur prapësimeve, ku ka pretenduar se ishte në pamundësi të provonte të ardhurat. Duke qenë se rezultoi e provuar se organet tatimore konfirmojnë regjistrimin e aktivitetit privat të vjehrrit të subjektit dhe nuk kanë dokumente për këtë periudhë, pagesa e detyrimeve tatimore për aktivitetin e ushtruar në nivelin minimal të të ardhurave duhet të prezumohet dhe, të paktën mbi bazën e këtij niveli, duhet të përlllogariten të ardhurat e realizuara në total për periudhën 1993 – 1999, në vlerën 606.702-lekë.

6.2. Në lidhje me të ardhurat nga të paktën tri ekspertimet e kryera në vitin 1997 nga bashkëshorti, sipas akteve në fashikuj, që subjekti ka arritur të mundësojë dhe të provojë në Komision, mbështetur edhe në llogaritjet e saj në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, do të rezultonte se potencialisht mund të vërtetohen të ardhura prej 120.000 lekësh¹⁸. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore, vlerësoj se qëndron arsyetimi i subjektit se bashkëshorti nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore, pasi vetë ligji i kohës nuk e lejonte regjistrimin e tij. Situata ligjore ka qenë e tillë që ai mund të ushtronte aktivitetin pa u regjistruar dhe të përfitonte të ardhura¹⁹. Bashkëshorti i subjektit, duke qenë i pajisur me licencën e përkohshme nr. 17, datë 15.01.1997, me afat vlefshmërie deri më 31.05.1997, është ngarkuar nga Dega e Tatimeve dhe Taksave Gramsh²⁰ për kontrollin e bilanceve të vitit 1996 të 18 subjekteve juridike. Në këto

¹⁸ Si total i: i) për subjektin “{***}”, ekspertimi i datës 30.03.1997, për 60 orë punë, rezulton 60.000 lekë; ii) për subjektin “{***}”, ekspertimi i datës 03.10.1997, për 30 orë punë, rezulton 30.000 lekë; iii) për subjektin “{***}”, për 30 orë punë, rezulton 30.000 lekë.

¹⁹ Kjo provohet me nenin 94 të Urdhërësës nr. 1, datë 02.10.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të autorizuar”, e cila parashikonte se: “... gjatë një periudhe prej jo më shumë se tre vjetësh nga hyrja në fuqi e kësaj urdhërese, papajtueshmëria e funksionit të ekspertit kontabël të autorizuar me postin e të punësuarit, nuk do të zbatohet për punonjës të shquar të administratës shtetërore ...”. Vitet '93 – '97 janë fillimet e profesionit të ekspertit kontabël, si një profesion i organizuar dhe me rregulla të veçanta, bazuar në akte ligjore e nënligjore, deri në datën 24.11.1997, kur u krijua Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Bashkëshorti i subjektit ka qenë i vetmi ekspert kontabël i autorizuar në qytet, që është ngarkuar të kryejë auditimin financiar.

²⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 05.03.1997.

kushte, duke mbajtur në konsideratë periudhën tranzitore deri në fillimin e funksionimit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar²¹, si dhe kur nuk ka pasur ekspert tjetër kontabël të autorizuar të licensuar në qytetin e Gramshit, e kur puna e kryer prej bashkëshortit të subjektit është kryer bazuar në VKM-në nr. 896, datë 30.12.1996, dhe urdhëresën në zbatim të tij, nxjerrë prej organit që ka si detyrë kontrollin e pagimit të tatimeve, vlerësoj se pagesa e detyrimeve tatimore duhet të prezumohet. Gjithashtu, përlllogaritja, mbajtja dhe pagesa e tatimit në burim bëhet nga përfituesi i shërbimit. Pra, nuk ka qenë detyrim i bashkëshortit të subjektit kryerja e kësaj pagese, qëndrim i mbajtur edhe nga vendimmarrjet e Kolegjit²².

7. Nëse do të konsideroheshin nga shumica sa më sipër, ato do të ndikonin në rezultatin e analizës financiare deri në vitin 2003. Subjekti dhe personat e lidhur sërish do rezultonin me diferencë negative, por më të vogël, prej (-) 1.397.065 lekësh, ose që kishin mundësi të krijonin kursime prej 4.302.935 lekësh.
8. *Për gjendjen cash në fund të vitit 2010 dhe në datën 03.03.2011*, kam vlerësuar se qëndron pretendimi i subjektit se likuiditeti *cash*, gjendje më 31.12.2010, është 1.500.000 lekë. Ky ndryshim, në krahasim me analizën e Komisionit dhe të vendimit të shumicës, rezulton me ndryshim në analizën e vitit 2010.

Kështu:

(i) subjekti ka sqaruar se gjendja *cash* në momentin e largimit nga detyra, datë 03.03.2011, ka qenë 1.500.000 lekë, deklaruar në DPV-në e vitit 2016 (dorëzuar më 27.03.2017), përpara fillimit të procesit të rivlerësimit;

(ii) dorëzimi i deklaratës së largimit nga detyra, datë 03.03.2011, dhe DPV-së së vitit 2010, në të njëjtën datë, më 29.03.2011, e afërsia në kohë, në kushtet kur nuk u evidentua që në periudhën 31.12.2010 – 03.03.2011 subjekti të ketë krijuar pasuri të tjera, e bën më të besueshme se gjendja e likuiditetit *cash* ka qenë e njëjtë;

(iii) subjekti, sipas shpjegimeve në pyetësin nr. 3, ka deklaruar se me likuiditetin *cash* në vitin 2010, ka blerë dy automjete dhe ka kryer një udhëtim në Turqi, e gjendja në fund të vitit 2010 ka qenë 1.500.000 lekë. Ky fakt gjen mbështetje edhe në Deklaratën Para Fillimit të Detyrës (DPFD) më 18.11.2016, ku subjekti ka deklaruar automjetin “{***}”, me burim “kursime nga pagat”, si dhe:

(iv) në procesverbalin me ILDKPKI-në, datë 07.02.2017, ka shpjeguar se gjendja më 31.12.2015 ishte 1.500.000 lekë (kohë kur subjekti nuk ishte subjekt deklarues) dhe ka pasur të njëjtën gjendje *cash* si në momentin e largimit nga detyra, datë 03.03.2011, ashtu dhe në fund të vitit 2010, pasi, sipas akteve dhe analizës në Komision, për periudhën kur subjekti nuk ka qenë në detyrë, nuk është evidentuar krijim pasurish.

²¹ Në pikën 1/a, VKM-ja nr. 896, datë 30.12.1996, “Për kontrollin e llogarive të shoqërive tregtare”, parashikohet se: “... kontrolli ligjor i llogarive të vitit financiar 1996 të shoqërive tregtare, qofshin këto private apo shtetërore etj. do të kryhet: a) nga specialistët që kanë kryer kurset e formimit profesional për ekspertë kontabël të autorizuar dhe të pajisur me licencë të përkohshme nga komisioni për krijimin e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar...”. Bashkëshorti i subjektit ka ndjekur kurset e formimit profesional për ekspert kontabël i autorizuar dhe është pajisur me licencën e përkohshme. Në zbatim të VKM-së nr. 896, datë 30.12.1996, drejtori i Degës së Tatimeve Gramsh, ka autorizuar bashkëshortin si ekspert për ekspertimin e 18 subjekteve juridike.

²² Një qëndrim i tillë është mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 14/2021 (JR) dhe në vendimin nr. 35/2022 (JR).

9. Pra, gjendja *cash* në fund të vitit 2010, duke konsideruar të bazuar pretendimin e subjektit, rezulton në vlerën prej 1.500.000 lekësh, 700.000 lekë më pak se konkluzioni i Komisionit dhe i shumicës në vendim. Në këtë analizë gjen vend edhe pretendimi i subjektit dhe shpjegimet që ka dhënë lidhur me blerjen e automjetit tip “Renault”, më datë 06.11.2010, se *ka pasur likuiditete cash që ka deklaruar, prej 1.500.000 lekësh, e kjo vlerë potencialisht përdoret gjatë vitit për kryerjen e shpenzimeve apo blerjen e pasurive dhe plotësohet nga të ardhurat vjetore e, në kushtet kur likuiditeti “cash” është i pamundur të përlllogaritet në një moment të caktuar gjatë vitit, për shkak se deklarimi për të kryhet vetëm në fund të vitit*, konstatohet se, referuar deklaramit të burimit në deklaratën *vetting* dhe atë DPFD, datë 18.11.2016, me burim *kursime nga pagat*, vlerësoj se është i bazuar pretendimi i subjektit që mund të ketë përdorur likuiditete *cash* përkohësisht dhe t’i ketë zëvendësuar në fund të vitit 2010 (ku ka ruajtur të njëjtën balancë likuiditeti *cash*. Subjekti ka deklaruar shtesa likuiditeti *cash*, në vitin 2008, prej 500.000 lekësh, e në vitin 2009 prej 700.000 lekësh, pra në total, prej 1.200.000 lekësh, e sipas rezultateve të Komisionit të viteve 2008 e 2009, minimalisht ka pasur mundësi kursimi prej 1.087.699 lekësh²³, që potencialisht mund të jenë përdorur, duke u mbështetur edhe nga deklarimi i burimit për krijimin e automjetit “Reno”, në 06.11.2010.
10. Në analizën *financiare të vitit 2010*, në ndryshim nga shumica, kam propozuar që të konsiderohej edhe dhurimi i të afërmit (nipi, familja R.), prej 1.958 USD ose 205.492 lekësh, me argumentet se: a) kjo shumë ka kaluar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në Raiffeisen Bank; b) koha e dhurimit është e afërt me vlerën tjetër të dhuruar, prej 7.000 USD, të cilat Komisioni dhe shumica në vendim i kanë konsideruar në analizën *financiare të vitit 2012*; c) në vitin 2010, nipi i personit të lidhur ka hyrë në marrëdhënie për blerje pasurie të paluajtshme në Shqipëri; ç) nipi ka pasur mundësi reale krijimi të ardhurash, provuar me dokumentacion ligjor, dhe; d) mbetet i pakuptimtë moskonsiderimi i kësaj shume të vogël nga shumica, ndërsa është pranuar dhurimi në një vlerë më të madhe, nga i njëjti person me të ardhura shumë të mira, të provuara nga aktiviteti i tij në ShBA.
11. Në analizën e kryer në Kolegj, sipas propozimeve të mësipërme të bëra në cilësinë e relatores, për të konsideruar pjesërisht disa nga pretendimet e subjektit në ankim, rezulton se vlerat do të ishin si më poshtë:
- 11.1. Për periudhën deri në fund të vitit 2003, mungesa e burimeve do të ishte në vlerën prej (-) 1.397.065 lekësh (duke konsideruar vlerën e ndërtimit të banesës 2-katëshe, sipas EKB-së, në shumën prej 2.249.938 lekësh, si dhe të ardhurat nga aktiviteti i vjehrrit, sipas pretendimit të subjektit, prej 606.702 lekësh, dhe të ardhurat e bashkëshortit në vitin 1997, prej 120.000 lekësh);
- 11.2. Për vitin 2010, mungesa e burimeve do të ishte në vlerën prej (-) 82.719 lekësh (duke konsideruar gjendjen e likuiditetit *cash* më 31.12.2010, prej 1.500.000 lekësh dhe dhurimin e familjes R., prej 205.492 lekësh);

²³ Në vitin 2008, nga kursimi “cash” i deklaruar, prej 500.000 lekë, ka pasur mundësi të kursente vlerën prej 472.991 lekësh (pasi diferenca negative e vitit ka rezultuar në përfundim prej -27.009 lekësh) dhe në vitin 2009, nga kursimi “cash” i deklaruar prej 700.000 lekësh, ka pasur mundësi të kursente vlerën prej 614.709 lekësh (pasi diferenca negative e vitit ka rezultuar në përfundim, prej -85.291 lekësh).

11.3. Duke përfshirë edhe vitin 2008, me mungesën e burimeve në vlerën prej (-) 27.009 lekësh dhe vitin 2009, me mungesën e burimeve në vlerën prej (-) 85.291 lekësh (ashtu siç janë konsideruar edhe nga shumica e trupit gjykues në vendim), diferenca negative në total për subjektin e rivlerësimit do të rezultonte në vlerën prej (-) 1.592.085 lekësh, për periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në detyrë (01.08.1991 – 03.03.2011 dhe 18.11.2016 – 31.12.2016).

12. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, si dhe duke mbajtur në konsideratë rrethanat e mëposhtme se:

i) subjekti i rivlerësimit ka ushtuar detyrën e gjyqtares në vitet e hershme, 1991 – 2000, në gjykatën e një qyteti të vogël, kohë kur nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarim pasurie;

ii) periudha e viteve 1991 – 2000, nuk përfshihet as në periudhën e rivlerësimit kalimtar, sipas përcaktimit ligjor të nenit 12, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;

iii) subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar në cilësinë e ndihmëses ligjore, detyrë të cilën e ka kryer në vitet 2000 – 2011 dhe 18.11.2016 e në vijim;

iv) nga analiza ekonomike e viteve të periudhës së rivlerësimit, sipas përlogaritjeve në Kolegj, u pranua që vitet 2008, 2009, 2010 të kishin vlera negative shumë të ulëta, të cilat nuk duhej ta penalizonin subjektin;

v) periudha e vetme me vlerën negative më të madhe është ajo e viteve 1991 – 2003;

vi) subjekti ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion,²⁴ sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme në vitin 1997 dhe pasojat që ajo la në vitet më pas;

– konkludoj se, në këtë çështje rivlerësimi, për shkak të veçorive të sipërcituara, duhej të gjenin zbatim parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit.

13. Për rrjedhojë, ankimi i subjektit të rivlerësimit duhet të pranohej, vendimi nr. 542, datë 20.06.2022, i Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit Brunilda Çarçiu, duhej të ndryshohej si i pabazuar në fakte e në ligj dhe subjekti të konfirmohej i besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

²⁴ Pranuar edhe nga Komisioni në vendim, për dokumentacionin e vjehrrit të subjektit.

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes nr. 45/2022 (JR), jam kundër vendimit nr. 16, datë 12.02.2026, me të cilin shumica e trupit gjykues vendosi: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 542, datë 20.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu*, konkluzion të cilin e konsideroj jo të drejtë dhe në kapërcim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, me arsyetimin si më poshtë:
 2. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, paraqitet kjo situatë faktiko-ligjore mbi funksionin dhe statusin e znj. Brunilda Çarçiu:
 - 2.1. Znj. Brunilda Çarçiu (Ago) është diplomuar juriste në datën 05.07.1991 dhe, pas përfundimit të studimeve, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh, detyrë të cilën e ka mbajtur nga data 01.08.1991 deri në datën 15.05.2000, kur me vendimin nr. 83, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), është liruar nga detyra e gjyqtares me kërkesën e saj.
 - 2.2. Në të njëjtën datë [15.05.2000], është emëruar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 01.03.2011. Me Urdhrin nr. {***} prot., datë 09.05.2012, KLD-ja ka urdhëruar emërimin e znj. Brunilda Çarçiu si specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Inspektoratit të KLD-së. Me vendimin nr. {***}, datë 18.11.2016, të KLD-së, znj. Brunilda Çarçiu është emëruar inspektore pranë IKLD-së.
 - 2.3. Në datën 27.01.2017, znj. Brunilda Çarçiu, në funksionin e inspektore pranë KLD-së, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë për rivlerësim *vetting*, si dhe dokumentacionin mbështetës. Në datën 30.01.2017, ajo ka depozituar formularin e vetëvlerësimit dhe dokumentet shoqëruese pranë KLD-së, si organ i vlerësimit të aftësive profesionale, duke qenë me detyrën e inspektore pranë ish-KLGJ-së.
 - 2.4. Me kërkesën e datës 10.04.2018, znj. Brunilda Çarçiu i është drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ONM-së, kryeinspektore së KLD-së dhe Shkollës së Magjistraturës, duke kërkuar t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar si ish-gjyqtare. Kjo kërkesë është bërë prej saj, pasi Shkolla e Magjistraturës i ka kërkuar të kryejë testimin profesional, ndërkohë që ajo duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar, për shkak të detyrës si inspektore e KLD-së dhe njëkohësisht si ish-gjyqtare.
 - 2.5. Me vendimin nr. {***}, datë 19.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka arritur në përfundimin se inspektorja Brunilda Çarçiu e ka ruajtur statusin e gjyqtarit, ka vendosur të deklarojë pasjen e statusit *magjistrat* prej saj.
 - 2.6. Pas kërkesës së Komisionit, që të përcaktojë qartësisht qëndrimin përfundimtar lidhur me procesin e rivlerësimit, për konsiderimin apo jo si subjekt rivlerësimi, në datën 19.10.2021, znj. Brunilda Çarçiu, ndër të tjera, ka parashtruar se *qenien si subjekt apo jo i ligjit, e lë në çmim të Komisionit*.

2.7. Sipas Komisionit, ndër të tjera, ka arsyetuar se vendimi i KLGJ-së, për dhënien e statusit të magistratit për znj. Brunilda Çarçiu, i shtrin efektet prapavepruese nga momenti i emërimit si inspektore, duke e barazuar plotësisht me subjektet e tjera, përpara mbarimit të afatit për paraqitjen e formularëve, pikërisht për të mundësuar nisjen e procesit të rivlerësimit. Për këto arsye, Komisioni ka vlerësuar se zgjidhja më e përshtatshme dhe në përputhje me vullnetin e shprehur nga subjekti, me frymën e ligjit dhe me interesin publik, do të ishte kryerja e rivlerësimit për këtë subjekt.

2.8. Në ankimin drejtuar Kolegjit, ankuesja parashtron se nuk e ka statusin e subjektit të rivlerësimit dhe se ndaj saj nuk duhet të kryhej procesi i rivlerësimit dhe, për këtë arsye, procesi në Komision duhet të përfundonte pa një vendim përfundimtar.

2.9. Shumica e trupit gjykues ka vlerësuar se *ankuesja, nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore në fuqi, është subjekt rivlerësimi, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, ajo gëzonte statusin e gjyqtarës dhe u përfshi në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, si të tillë. Ankuesja, për shkak të ruajtjes së statusit të gjyqtarës, konfirmuar edhe me vendimin nr. {***}, të datës 19.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të shprehjes së vullnetit për t'u rikthyer në sistemin e drejtësisë, konsiderohet subjekt rivlerësimi dhe duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit ex officio, sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016.*

3. Në vlerësimin tim, shumica e trupit gjykues nuk i ka dhënë zgjidhje të drejtë çështjes, duke e konsideruar znj. Brunilda Çarçiu, subjekt rivlerësimi, në kapërcim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, të cilat nuk i përgjigjen situatës reale faktike dhe ligjore të konstatuar.

Më konkretisht: (i) ligji nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është miratuar në datën 22.07.2016, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 27.07.2016, dhe ka hyrë në fuqi pas 15 ditësh, pra në datën 11.08.2016; (ii) ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u miratua në Kuvend më datë 30.08.2016, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.09.2016, dhe ka hyri në fuqi në datën 08.10.2016. Znj. Çarçiu, deri në momentin e hyrjes në fuqi të paketës ligjore të procesit të rivlerësimit, nuk ka qenë subjekt rivlerësimi, por ka ushtruar për një periudhë prej më shumë se 5 (pesë) vitesh, detyrën e specialistes në administratën e ish-KLD-së, deri në datën 18.11.2016, kur është emëruar inspektore pranë ish-KLD-së.

Në këto kushte, ankuesja nuk ka gëzuar statusin e përcaktuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, por as atë të përcaktuar në pikën 4 të kësaj dispozite, në kushtet kur nuk kishte bërë kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas përcaktimit në nenin 31, pika 3 e këtij ligji, për t'iu nënshtrohet këtij procesi si ish-gjyqtare.

4. Për këto arsye, ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues dhe vlerësoj se znj. Brunilda Çarçiu nuk duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, në kushtet kur statusi i saj profesional, në këtë moment procedural, duket qartë që nuk i përgjigjej përcaktimeve të kërkuara për subjektet e rivlerësimit nga kuadri ligjor i zbatueshëm në këtë proces.

5. Arsyetimi i shumicës, se statusi i saj si magjistrate është konfirmuar nga vendimi nr. {***}, datë 19.12.2019, i KLGJ-së, në vlerësimin tim, nuk sjell pasoja prapavepruese, të tilla që do të legjitimonin pasjen e statusit subjekt rivlerësimi, me pasojë nënshtrimin ndaj këtij procesi. Vlerësoj se, nëse KLGj-ja ka konstatuar ekzistencën e statusit të magjistrates, në vitin 2019, pra pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore që kanë përcaktuar se cilët janë subjektet e rivlerësimit, më së paku, do të ishte ky organ që duhet të bënte kontrollin institucional mbi kriteret vlerësuese, për magjistratët që nuk janë fotografuar si të tillë, në momentin e hyrjes në fuqi të paketës ligjore të sipërcituar. Për sa më sipër, analizimin e vendimit nr. {***}, datë 19.12.2019, të KLGJ-së, e vlerësoj pa ndikim në zgjidhjen e kësaj çështjeje, ndryshe sa ka arsyetuar shumica.
6. Për sa arsyetuar më sipër, vlerësoj se shumica e trupit gjykues ka gabuar, kur e ka konsideruar ankuesen Brunila Çarçiu, subjekt rivlerësimi, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit të rivlerësimit, nuk ishte në listën e subjekteve të rivlerësimit sipas nenit 179/b, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 76/2016: [...] *Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet [...] dhe për këtë vendimi i Komisionit dhe i shumicës së trupit gjykues në Kolegj gjendet i padrejtë dhe i pambështetur në Kushtetutë dhe në ligjin e zbatueshëm. Prandaj kam votuar kundër vendimmarrjes së tyre dhe, me këtë arsyetim, mbështes pakicën time. Në këtë rast, sipas kërkesave të nenit 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, shumica e trupit gjykues, bazuar në juridiksionin kontrollues të vendimit të Komisionit, duhet të kishte vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Komisionit për zbatim të gabuar të ligjit.*

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi